

## Përmbajtja

1. Lënda e hulumtimit.....	3
2. Qëllimet e hulumtimit.....	4
3. Hipotezat.....	5
4. Metodologjia e hulumtimit.....	6
5. Rëndësia e punimit .....	7
Hyrje.....	8
Kapitulli i parë .....	9
1. Aspekte historike të sanksioneve penale .....	9
1.1 Zhvillimi historik i sanksioneve penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	10
1.2 Zhvillimi historik i sanksioneve penale në Republikën e Kosovës .....	13
Kapitulli i dytë .....	15
1. Përkufizimi i sanksioneve penale.....	15
1.1 Përkufizimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	15
1.2 Përkufizimet në Republikën e Kosovës.....	16
2. Ndarja e sanksioneve penale .....	17
2.1 Llojet e sanksioneve penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut me theks të veçantë në dënimet kryesore, dënimet plotësuese, masat alternative dhe masat e sigurisë .....	17
2.2 Llojet e sanksioneve penale në Republikën e Kosovës me theks të veçantë në dënimet kryesore, dënimet plotësuese, dënimet alternative dhe masat e trajtimit të detyrueshëm .....	18
Kapitulli i tretë.....	19
1. Sanksionet penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	19
1.1 Dënimet kryesore dhe dënimet plotësuese .....	19
1.2 Masat alternative.....	24
1.3 Masat e sigurisë .....	31
2. Sanksionet penale në Republikën e Kosovës.....	34
2.1 Dënimet kryesore.....	34

2.2 Dënime plotësuese .....	37
2.3 Dënime alternative .....	41
2.4 Masat e trajtimit të detyrueshëm.....	49
Kapitulli i katërt.....	52
1. Ngjashmëritë dhe dallimet .....	52
1.1 Ngjashmëritë dhe dallimet e Dënimeve kryesore .....	52
1.2 Ngjashmëritë dhe dallimet e Dënimeve plotësuese.....	55
1.3 Ngjashmëritë dhe dallimet e Masave alternative .....	57
1.4 Ngjashmëritë dhe dallimet e Masave të trajtimit të detyrueshëm.....	59
2. Konkluzione dhe rekomandime.....	60
Përfundimi.....	62
Bibliografia .....	64

## 1. Lënda e hulumtimit

Lëndë e hulumtimit në këtë temë do të jenë sanksionet penale e të dy vendeve fqinje, Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe Republikës së Kosovës.

Në këtë temë do të bëhet një analizë e përgjithshme e të gjitha llojeve të sanksioneve penale duke u nisur nga ajo se cilët janë ato lloje, në cilat raste shqiptohen, cilat kushte duhet të përmbushen për shqiptimin e atyre llojeve të sanksioneve penale, a ka ndonjë ndryshim gjatë shqiptimit të këtyre sanksioneve apo kushtet për shqiptimin e tyre janë të njëjta apo përafërsisht të ngjashme në të dy vendet e kështu me radhë.

## 2. Qëllimet e hulumtimit

Duke u bazuar në atë se secili vend ka lloje të ndryshme të sanksioneve penale varësisht nga llojet e kriminalitetit të cilët janë më shumë të zhvilluara në atë vend ne do ta shqyrtojmë këtë temë si krahasim mes dy vendeve të cilat janë të ngjashme në shumë aspekte, për mos thënë të njëjtë.

Si qëllim kryesor për hulumtimin e kësaj teme është që të nxirren në pah si fillim pikat e përbashkëta e sanksioneve të njëjta ose të ngjashme penale. Pas kësaj do të shohim se ku ka ndryshime gjatë shqiptimit të sanksioneve penale. Do të fokusohemi në atë se a ka ndonjë lloj të sanksionit penal i cili nuk është i njëjtë në të dyja vendet, mirëpo do të duhej të ishte sepse në vendin ku shqiptohet ka treguar rezultat në uljen e aktiviteteve kriminale apo në përmirësimin dhe risocializimin e kryerësve të veprave penale. Ose ndoshta thjesht mënyra e shqiptimit të ndonjë sanksioni ndryshon dhe kjo ka bërë që i njëjti sanksion në njërin vend të tregojë rezultate më të mira se sa në vendin tjetër.

Qëllim tjetër do të jetë që me analizën e detajshme të bërë të të gjitha llojeve të sanksioneve penale të mund të nxjerrim ndonjë konkludim më të përgjithshëm rreth asaj se sa kanë ndikim pozitiv sanksionet penale në vendet tona, sa ato ndikojnë në uljen e kriminalitetit dhe se a do të duhet të behet ndonjë ndryshim të shtohet apo të hiqet ndonjë lloj i sanksioneve penale apo thjesht të ndryshohet mënyra e shqiptimit të sanksionit.

### 3. Hipotezat

#### **Hipoteza 1**

Si përkufizohen sanksionet penale dhe çfarë lloje të sanksioneve penale ka në të dyja vendet?

#### **Hipoteza 2**

Të analizohen të gjitha llojet e sanksioneve penale veç e veç, duke shpjeguar se kur ata shqiptohen në cilat raste dhe në çfarë rrethana si dhe cilat kushte duhet të përmbushen për shqiptimin e tyre?

#### **Hipoteza 3**

Të nxirren në pah pikat e përbashkëta dhe të veçanta të sanksioneve penale dhe me këtë të mund të nxjerrim një përfundim rreth asaj se a janë të gjitha llojet e sanksioneve penale të mjaftueshme për pengimin e kriminalitetit në këto dy vende apo së paku për uljen e numrit të kriminalitetit apo do të duhet të bëhen disa ndryshime si në njërin vend ashtu edhe në tjetrin?

## 4. Metodologjia e hulumtimit

Gjatë shqyrtimit dhe punimit të kësaj teme do të shfrytëzohen lloje të ndryshme të materialeve të gjithë ata që do të ndihmojnë për hulumtimin sa më të detajshëm dhe sa më të suksesshëm të kësaj teme duke filluar nga librat e autorëve të ndryshëm, kodeve dhe ligjeve të të dyja vendeve, materiale të nevojshme nga faqet e ndryshme të internetit etj.

Metodat të cilat do të përdoren për hulumtimin e kësaj çështje janë:

**Metoda historike-** si fillim për të bërë analizën e llojeve të sanksioneve penale duhet të njihemi me atë se për cilat shtete bëhet fjalë, a janë shtete të njëjta, të ngjashme apo të ndryshme mes vete, si për nga shtrirja e territoreve ashtu edhe për nga zhvillimi i tyre ekonomik, politik e kulturor.

**Metoda analitike dhe sintetike-** këto dy metoda do të përdoren kryesisht për ti analizuar të gjitha llojet e sanksioneve penale ne veçanti. Për të bërë një analizë më të detajshme të secilit lloj të sanksioneve penale.

**Metoda krahasimore-** do të behet krahasim i llojeve të sanksioneve penale duke u fokusuar në atë se ku këta lloje të sanksioneve penale janë të njëjta plotësisht dhe ku ka ndryshime mes tyre.

**Metoda statistikore-** do të përdoren lloje të ndryshme të statistikave për të treguar rolin dhe rëndësinë e sanksioneve penale në uljen e kriminalitetit.

**Metoda e klasifikimit-** do të klasifikohen llojet e sanksioneve penale sipas vetive të ndryshme.

## 5. Rëndësia e punimit

Rëndësia e këtij punimi qëndron pikërisht në zhvillimin e pandalshëm të shoqërisë në shumë aspekte. Me zhvillimin e shoqërisë sigurisht se bëhet edhe zhvillimi i llojeve të ndryshme të kriminalitetit. E me zhvillimin sa më të madh të kriminalitetit paraqitet nevoja që çdoherë e më shumë të bëhen hulumtime dhe të shikohen se a janë të mjaftueshme llojet e masave që i ndërmerr shteti për parandalimin dhe pengimin e kriminalitetit si dhe për risocializimin dhe riedukimin e kryerësve të veprave penale.

Analiza dhe punimi i kësaj teme qëndron pikërisht në atë që ti ofrohet një ndihmë shtetit me ide dhe mendime të reja se si shteti do të duhet që ti përshtat masat që duhet të ndërmerren për parandalimin dhe pengimin e kriminalitetit me ndryshimet e shumta që ndodhin në shoqëri.

Meqë shoqëria vetvetiu është një proces dinamik, atëherë kjo do të thotë që edhe shteti dhe masat të cilat i ndërmerr shteti për secilën çështje duhet të jenë dinamike dhe të përputhen me ndryshimet e shoqërisë në mënyrën që të përshtaten sa më shumë.

## Hyrje

Që një shtet të funksionojë si duhet dhe të jetë demokratik, patjetër duhet t'i mbrojë liritë dhe të drejtat e qytetarëve të tij. Për tu mbrojtur këto të drejta është e nevojshme që të gjithë atyre të cilët do ti cenojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve të ju shqiptohet sanksion i caktuar penale i cili edhe do ti mbrojë liritë dhe të drejtat e të gjithë qytetarëve dhe të mos i cenoj të drejtat e kryerësit të veprës penale. Që të realizohen të dyja njëkohësisht është pothuajse e pamundur, ndaj do të duhet që përveç dënimeve si sanksione penale për veprat e rënda penale, të ekzistojnë edhe masa të tjera të cilët në një farë mënyre do të jenë në përputhje me veprat më të vogla penale, apo me ata vepra për të cilët kryerësit i kanë kryer për arsye të vetëdijes së zvogëluar apo edhe pavetëdijes së tyre të plotë.

Edhe pse fjala dënim ka kuptimin e marrjes apo kufizimit të disa të drejtave, përsëri mënyra e marrjes së këtyre të drejtave duhet të realizohet në mënyrë humane, që kryerësit të mos i kufizohet asgjë më shumë nga ajo e patjetërsueshmja dhe asgjë më pak nga e nevojshmja. Rëndësi të posaçme duhet t'i kushtohet edhe procesit të riintegritimit dhe risocializimit të të dënuarve, si dhe mundësia e rikthimit të tyre në shoqëri si persona të parrezikshëm.

Nga nevoja që sistemi i sanksioneve penale duhet të ndryshojë vazhdimisht për t'iu përshtat më shumë ndryshimeve shoqërore dhe formave të ndryshme të kriminalitetit, për ta arritur qëllimin e risocializimit të personave të dënuar dhe drejtësinë është e udhës që të bëhen krahasime mes sistemeve penale të dy apo më shumë vendeve për të parë nëse diçka duhet ndryshuar brenda sistemit tonë apo edhe për të vërtetuar që sistemi është bukur mirë i formuar dhe për t'u sugjeruar ndonjë ndryshim në vendet tjera.



Në këtë temë do të bëhet krahasimi i sistemeve të sanksioneve penale të dy vendeve fqinje Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës, pikërisht për shkak të ngjashmërive që këto dy vende i posedojnë.

## Kapitulli i parë

### 1. Aspekte historike të sanksioneve penale

Në periudhën bashkëkohore të zhvillimit të veprës penale evolucioni i sistemit të sanksioneve penale ka kaluar nëpër disa etapa. Fryt i reformës së parë penalo-juridike nga fillimi i shek. XIX është zhvillimi i atij sistemi në shenjë të një sanksioni – dënimi, më sakt dënimi më dominues – burgu. Reforma e dytë penalo-juridike nga fillimi i shek. XIX e inauguron sistemin dualist të sanksioneve: dënime dhe masa të sigurisë. Në shek. XX të ashtuquajturit: “binarë të dyfishtë”, ende janë thjeshtë të pa ndërtuar me sistemin pluralist të sanksioneve: dënime, masa vërejtëse dhe masa të sigurisë. (Osmani, Penologjia, 2017, p. 105)

Sistemi bashkëkohor i sanksioneve është i modeluar si sistem pluralist, përveç dënimit si sanksion themelor, ai i përmban edhe sanksionet vërejtëse (admonitive) dhe masat e sigurisë. [...] Koncepti i dënimit bashkëkohor ka kaluar rrugë njëshekullore ku mund të etiketohen dy pika: poenta e qasjes funksionaliste mbi kontrollin e kriminalitetit dhe qëndrimi bashkëkohor, pluralizmi radikal konstant i dënimit. (Osmani, Penologjia, 2017, p. 106)

Për një periudhë të gjatë kohore, si mjete dhe metoda të vetme të luftës kundër kriminalitetit, kanë dominuar dënimet fizike dhe trupore, torturat fizike dhe psikike si dhe dënimet me vdekje. Më vonë, fillojnë të aplikohen edhe dënime të tjera si: dënimet në të holla, dënimet në konfiskim të pasurisë, dënimet me privim të lirisë ose me burgim. [...] Si metoda dhe mjete për pengimin e kriminalitetit, përveç dënimeve, më vonë parashikohen edhe sanksione të tjera, si dënimet plotësuese, masat mbrojtëse, masat edukative ndaj të miturve, masa të zëvendësimit të dënimeve si dënime plotësuese, dënime alternative dhe masa e mjete tjera të parandalimit të kriminalitetit. (Halili, 2014, pp. 65-66)

Në penologjinë bashkëkohore dhe në të drejtën penale sanksionet penale karakterizohen me zhvillimin dhe forcimin e një raporti të ri të shoqërisë ndaj delikuentit gjegjësisht të dënuarit. Kjo ka të bëjë me synimin që i dënuari të riedukohet dhe të kthehet sa më shpejtë në shoqëri si qytetarë korrekt.

Po ashtu këto veti kanë të bëjnë edhe me faktin që i dënuari tani nuk shikohet si armik i shoqërisë dhe vërehet tendenca e vendosjes së një baraspeshe në mes të prevencionit individual dhe atij gjeneral. Përpjekja për gjetjen e masave- sanksioneve alternative të cilat më pak kanë karakter represiv gjithashtu është një tendencë dhe karakteristikë e re e sanksioneve penale. (Halili, 2014, p. 66)



## 1.1 Zhvillimi historik i sanksioneve penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Baza e çdo teorie politike demokratike mbështetet në njeriun dhe lirinë e tij, e ajo do të thotë në të kuptuarit dhe vërtetimin se të drejtat dhe liritë janë dhe mund të jenë, realitet, të drejta dhe liri të vërteta-nëse ka demokraci, dhe që të ketë demokraci. Liritë dhe të drejtat e njeriut

nuk janë të dizuara dhe të lejuara, por me Kushtetutë janë të vërtetuara dhe të garantuara. (Klimovski, Mitkov, Treneska, & Karakamisheva, 2004, p. 54)

Meqë Republika e Maqedonisë kohë të gjatë ishte nën sundimin e të huajve, në territorin e saj aplikohet drejta e sunduesit, ndonëse në disa regjione të saj me mjaft sukses i kundërvihet drejta zakonore shqiptare mjaftë e zhvilluar. E drejta zakonore shqiptare e përmbledhur në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe në kanune tjera të trevave shqiptare përmban, përveç tjerash, një sistem normash juridiko-penale dhe procedurale sipas të cilave ndëshkoheshin kryerësit e veprave penale. (Sahiti & Zejneli, 2017, p. 18)

Sistemi i sanksioneve i paraparë në KPM, i përmban të gjitha karakteristikat e sistemit pluralist. Ai përmban: dënime, masa alternative, masa të sigurisë dhe masa edukuese. Por i njëjti, është pluralist vetëm sipas strukturës së tij, e komponuar nga më shumë lloje sanksionesh. Në themel, bëhet fjalë për sistem të mirë të integruar të sanksioneve të unifikuara dhe të konceptuara mbi dënimin si sanksion themelor. Dënimi si dhe alternativat e tij të vetme janë sanksionet për të rritur, të përgjegjshëm dhe persona fajtorë. Koncepti i këtillë i sistemit të sanksioneve është fryt i fazës së dytë të reformës së legjislaturës penale, e realizuar me ndryshimet në KPM të vitit 2004. (Zejneli & Kambovski, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, 2018, pp. 248-249)

Me këto ndryshime janë llogaritur jo konsekuencat e sistemit të trashëguar nga e drejta penale e ish-Jugosllavisë, për të cilin ishin karakteristike mbeturinat për idenë e “shtegut të dyfishtë” përveç repertorit të reduktuar të dënimeve më shumë sanksione me karakter punitiv kanë qenë të parapara si masa të sigurisë. Repertori i sanksioneve vërejtëse ka qenë po ashtu i reduktuar në dy sanksione: dënim me kusht dhe vërejtje gjyqësore. Bëhej fjalë për shkelje eklekante, ku me idenë për dënim retributiv kanë qenë sanksione të llojit të masave të sigurisë. Me dy dënime, dy sanksione vërejtëse dhe shtatë masa të sigurisë, sistemi i sanksioneve në mënyrë optike dukej si sistem i orientuar preventiv. (Osmani, Penologjia, 2017, p. 207)

Me ndryshimet e KPM-së të vitit 2004, të gjitha sanksionet me karakter punitiv janë të sistematizuara si dënime, numri i të cilëve është rritur në pesë. Repertori i masave të sigurisë përkundër kësaj është i reduktuar në tri masa. Masa e sigurisë së mëparshme: marrje e sendeve së bashku me konfiskimin e pasurisë dhe shfrytëzim i pasurisë janë të parapara si masa të posaçme penalo-juridike.

Sistemin e këtillë të konceptuar e karakterizon padyshim shkalla e lartë e humanizmit: ai nuk parasheh dënim me vdekje ose masa ekskomunikuese “të sigurisë” ose dënime afatgjate të heqjes nga liria. Me sistem të ri të sanksioneve, nga njëra anë është theksuar koncepti social-etik i së drejtës penale, parimi i ligjshmërisë, parimi i fajësisë dhe i drejtësisë, kurse nga ana tjetër iu është përgjigjur kërkesës për modernizimin e saj nëpërmjet inaugurimit të masave të ndryshme alternative. Përpos konfiskimit dhe marrjes së sendeve që kanë karakter të masave të veçanta penalo-juridike, etike-neutrale dhe të lidhura për pasojat e veprës penale, regjimi i posaçëm është paraparë edhe për pasojat juridike nga dënimi. (Zejneli & Kambovski, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, 2018, pp. 248-249)

Sanksioni bazë - dënimi, është sanksion retributiv që njëkohësisht u shërben qëllimeve të preventivit, si kthim i zbatueshëm për veprën e bërë, ajo megjithatë është më shumë sanksion retributiv se sa preventiv. Ndërrimi për dënim do të thotë masë alternative. Te ata është i theksuar funksioni preventive- ata janë më shumë sanksione preventive e më pak retributive. Karakteristikë tjetër në sistemin e ri të sanksioneve është fleksibiliteti: repertori i gjerë i dënimeve është kornizë e qëlluar në të cilën mund të realizohet përcaktimi për zbatim restriktiv të burgut dhe dënimit në përgjithësi për rastet më të rënda dhe për zbatim më të madh të masave alternative për rastet më të lehta të veprës penale. Linja kufizuese e imagjinuar e rasteve në të cilat me rregull duhet të zbatohet dënimi dhe rastet ku duhen të zbatohen masat alternative, bien në veprat më të lehta për të cilat janë përshkruar dënime me të holla ose dënim me burgim deri në tre vjet. Masat e sigurisë janë të rezervuara për kategoritë e veçanta të kryerësve të papërgjegjshëm, alkoolikëve dhe narkomanëve dhe kanë karakter ekskluzivisht të masave të detyrueshëm medicinale për shërim. Me pozicionin e tillë të tyre është tërhequr vija e qartë e kufizimit mes dënimit dhe masave të sigurisë si sanksione speciale preventive,

qëllimi i tyre është ekskluzivisht preventive, shërimi i kryerësit të veprës dhe zbatohen vetëm kur nevoja për shërim të detyrueshëm është e imponuar me rrezikun që kryerësi përsëri të kryejë veprë penale për shkak të gjendjes shpirtërore. (Osmani, Penologjia, 2017, pp. 108-109)

## 1.2 Zhvillimi historik i sanksioneve penale në Republikën e Kosovës

Hierarkia e akteve juridike në Kosovë ka qenë specifike dhe mund të trajtohet në dy periudha;

Periudha para aprovimit të kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe periudha Pas aprovimit të kushtetutës dhe shpalljes së pavarësisë:

Struktura ligjore në Kosovë në periudhën para aprovimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është shumë komplekse . Komplexiteti është ekzistues për shkak të normave dhe akteve të ndryshme nga ish - Jugosllavia të cilat kanë vazhduar të jenë në fuqi, rregulloretë të UNMIK-ut, ligjeve të Kosovës para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës dhe ligjeve të cilat kanë hyrë në fuqi pas kushtetutës.

Po ashtu kompleksiteti i Hierarkisë së Akteve Juridike, krijohet edhe në raport me konventat ndërkombëtare dhe supremacion në krahasim me ligjet e aplikueshme vendore pasi që kjo në mënyrë shprehimore nuk është e përcaktuar me ligje.

Duke filluar nga periudha e përfundimit të luftës në Kosovë, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në mbështetje të Kartës së OKB-së me 10 qershor 1999 aprovoi rezolutën Nr. 1244 me anë të së cilës themeloi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)

Vendosja e UNMIK në Kosovë me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, miraton si akt të parë Rregulloren e UNMIK 1999/1 e cila, në nenin 4, përcakton ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Sipas saj thuhet "Ligjet e Kosovës të cilat kanë qenë në fuqi në territorin e saj para datës 24 mars 1999 do të vazhdojnë të zbatohen në Kosovë nëse nuk bien në kundërshtim me standardet e përmendura në Nenin 2, me përmbushjen e mandatit të

dhënë UNMIK-ut me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose me këtë rregullore a çdo rregullore tjetër të nxjerrë nga:

Rregullorja e UNMIK 1999/1 e plotësuar me Rregulloren e UNMIK 1999/24, Neni 1 ka paraparë ligjet e aplikueshme në Kosovë. Sipas tyre ligji i aplikueshëm është:

a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to, dhe

b) Ligjin në fuqi në Kosovë deri më 22 mars 1989.

c) Ligjet e nxjerra pas 22 mars 1989 me kusht që dispozitat e tyre të mos kenë karakter diskriminues dhe të mos jenë në kundërshtim me dispozitat e konventave dhe praktikave ndërkombëtare, dispozitë kjo e cila mund të zbatohen në praktike si përjashtim sipas Nenit 1.2 të rregullores në fjale – 1.2.

Pas datës 15 qershor 2008 dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës kemi një ndryshim të procesit dhe krijim të një hierarkie ligjore më të qartë dhe një konkretizim të supremacionit të akteve juridike. Kushtetuta e Kosovës në nenin 16 flet për hierarkinë ligjore.

Në ndërkohë neni 19 i kushtetutës rregullon zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare. Pika 1, Neni 19 thotë “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetë zbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndërkohe që pika 2, neni 19 thotë “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës”. (Hoxha, n.d.)

Sanksionet penale sipas Legjislacionit Penal të Kosovës, kanë ndryshuar në masë të konsideruar në krahasim me legjislacionin e më parë që aplikohet në Kosovë. Kodi i ri Penal i Kosovës ka paraparë disa risi, kështu që ai parasheh dënime të reja që nuk ekzistonin më parë ose

emërtoheshin ndryshe. Në kuadër të sistemit juridik, Kosova në dispozitat e saj pozitive ka përvetësuar edhe dënimin me burgim të përjetshëm, pra ky lloj dënimi i ka zëvendësuar dënimin me burgim afatgjatë, gjithashtu në kuadër të risive që janë paraparë në legjislacionin e ri të Kosovës janë edhe dënimet alternative dhe dënimet plotësuese. (Halili, 2014, p. 67)

## Kapitulli i dytë

### 1. Përkufizimi i sanksioneve penale

#### 1.1 Përkufizimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sanksioni në kuptimin penalo-juridik nënkupton zbatimin e masave të detyrueshme ndaj shkelësit të normave për shkak të veprës së kryer me shkeljen e normës penalo-juridike. Sanksioni është masë e detyrueshme që kryerësit ia shqipton gjykatësi, nëpërmjet vendimit gjyqësorë të detyrueshëm shtetërorë, me ligj i përcaktuar si reaktion për veprën e kryer. Përmbajtja e saj është marrja apo kufizimi i disa të drejtave të kryerësit të veprës, shërimi i tij i detyrueshëm ose trajtimi i detyrueshëm paraqiten në formë të dënimit, masat alternative, masat e sigurisë dhe masat edukuese. (Osmani, Penologjia, 2017, p. 100) (Zejneli & Kambovski, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, 2018, p. 243)

Për termin e sanksionit penalo-juridik janë të rëndësishëm elementet në vijim: e para, se ajo është pasojë juridike që e godet kryerësin për shkak të kryerjes së veprës penale, e dyta, sanksioni penalo-juridik është masë e detyruar që e shqipton gjykata dhe e treta, sanksioni penalo-juridik përbëhet në marrjen ose në kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të kryerësit ose shërimin e detyruar ose trajtimin në liri, apo masa të ndihmës dhe mbrojtjes. (Zejneli & Kambovski, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, 2018, p. 243)

## 1.2 Përkufizimet në Republikën e Kosovës

Sanksionet penale janë masa të shtrëngimit të parapara me dispozita pozitive ligjore të cilat aplikohen ndaj kryerësve të veprave penale. Sanksionet penale paraqesin një rëndësi nga masat me të cilat shoqëria mbrohet nga kriminaliteti. Ato janë forma të reagimit të shtetit ndaj veprave penale të qytetarëve. Ato zakonisht aplikohen ndaj kryerësve të veprave penale me qëllim të mbrojtjes së të mirave të rëndësishme të shtetit dhe individit. Sanksionet penale janë masa të karakterit shtrëngues të cilat i shqipton gjykata kompetente në procedurë të paraparë ligjore ndaj kryerësit të veprës penale. Sanksionet penale gjithmonë që më parë janë të parapara me ligj dhe përherë nënkuptojnë shtrëngimin ndaj kryerësit të veprës penale i cili përherë pëson duke iu marrë ndonjë e drejtë ose e mirë ose i kufizohen disa të drejta dhe të mira tjera. (Halili, 2014, pp. 65-66)

Sanksionet penale si masa mbrojtëse cilësohen mjetet për pengimin e kriminalitetit sigurimin e rendit shoqëror nga atakimet e rrezikshme dhe kundërligjore të individëve dhe grupeve të caktuara. Sanksionet penale shqiptohen dhe aplikohen kundër vullnetit të kryesit dhe konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat përndryshe i kanë gëzuar gjerë në momentin e kryerjes së veprës penale. Sanksionet penale që i shqiptohen kryesve të veprave penale më pak kanë karakter hakmarrës e më tepër shqiptohen më qëllim të përmirësimit. (Hoxha, n.d.)



## 2. Ndarja e sanksioneve penale

### 2.1 Llojet e sanksioneve penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut me theks të veçantë në dënimet kryesore, dënimet plotësuese, masat alternative dhe masat e sigurisë

Sanksionet penale sipas legjislacionit penal të Maqedonisë kanë ndryshuar në masë të konsideruar në krahasim me periudhat e mëhershme që aplikoheshin në Maqedoni. Kodi penal i RM-së parasheh edhe disa risi, që nuk ekzistonin më parë. Në këtë drejtim veçohen risi në kuadër të dënimeve plotësuese, si dhe në masat e sigurisë. Po ashtu risi është edhe fakti se tani sanksionet penale ndaj të miturve nuk rregullohen me Kodin Penal, por me Ligjin për drejtësi për fëmijët, me të cilin edhe përcaktohen rregullat mbi ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj fëmijëve. (Osmani, Penologjia, 2017, p. 109)

Sanksione penale janë: dënimet, masat alternative, masat e sigurisë dhe masat edukuese. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 40) ( Neni 4 )

## 2.2 Llojet e sanksioneve penale në Republikën e Kosovës me theks të veçantë në dënimet kryesore, dënimet plotësuese, dënimet alternative dhe masat e trajtimit të detyrueshëm

Sanksionet penale sipas Legjislacionit Penal të Kosovës, kanë ndryshuar në masë të konsideruar në krahasim me Legjislacionin e më parme që aplikohet në Kosovë. Kodi i ri Penal i Kosovës ka paraparë disa risi, kështu që ai parasheh dënime të reja që nuk ekzistonin më parë ose emërtoheshin ndryshe. Në kuadër të sistemit juridik, Kosova në dispozitat e saj pozitive ka përvetësuar edhe dënimin me burgim të përjetshëm, pra ky lloj dënim e ka zëvendësuar dënimin me burgim afatgjatë. Gjithashtu në kuadër të risive që janë paraparë në legjislacionin e ri të Kosovës janë edhe dënimet alternative dhe dënimet plotësuese.

Po ashtu risi është edhe fakti se tani sanksionet penale ndaj të miturve nuk rregullohen me Kodin Penal të Kosovës por me Kodin e drejtësisë për të mitur të Kosovës me të cilin edhe përcaktohen rregullat mbi ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj të miturve. (Halili, 2014, p. 67)

Sanksionet penale janë: dënimet kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese dhe vërejtja gjyqësore. (Republika, 2019, p. 2) ( Neni 4 )

## Kapitulli i tretë

### 1. Sanksionet penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

#### 1.1 Dënimet kryesore dhe dënimet plotësuese

Për vepra penale të kryerësve që kanë përgjegjësi penale mund t'u shqiptohen këto dënime:

1. Dënim me burgim
2. Dënim me gjobë
3. Ndalesë për të ushtruar profesion, veprimtari apo detyrë
4. Ndalesë për të drejtuar automjetin
5. Dëbim i të huajt nga vendi
6. Ndalesë për vizitimin e ndeshjeve sportive. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 55) ( Neni 33 )

Dënimet ndahen në dy grupe: kryesore dhe plotësuese. Në grupin e parë bëjnë pjesë: dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë, kurse në grupin e dytë, në dënimet plotësuese bëjnë pjesë: ndalesa për të ushtruar profesion, veprimtari ose detyrë, ndalesa për të drejtuar automjetin, dëbimi i të huajt nga vendi dhe ndalesa për vizitimin e ndeshjeve sportive.

Qëllimi i ndëshkimit

Përpos realizimit të drejtësisë, qëllimi i ndëshkimit është:

- 1) Pengimi i kryerësit të kryejë vepra penale dhe riedukimi i tij, dhe
- 2) Në mënyrë edukative të ndikojë ndaj të tjerëve të mos kryejnë vepra penale. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 55) ( Neni 32 )

### *Dënimi me burgim*

Dënimi me burgim, mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesorë. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 55) ( Neni 33 ).

Burgimi nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë, as më i gjatë se 20 vjet. Për veprat penale për të cilat është paraparë edhe dënim me burgim të përjetshëm, mund të shqiptohet dënim me burgim afatgjatë prej 40 vjet. Nëse për vepër penale e kryer me dashje është paraparë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 vjetësh, për forma të rënda të asaj vepre mund të caktohet edhe burgim i përjetshëm. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të caktohet si dënim i vetëm kryesorë. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet kryerësit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mbushur 21 vjet të jetës. Burgimi shqiptohet në vite dhe muaj të plotë, kurse deri në 6 muaj edhe në ditë të plota. Kur për vepra penale është paraparë burgim pa theksuar masën më të vogël, kurse masa më e madhe nuk është më shumë se 3 vjet, përpos atij dënimi detyrimisht përcaktohet edhe dënimi me të holla. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 57)( Neni 35 )

### *Dënimi me gjobë*

Dënimi me gjobë shqiptohet në gjoba ditore, me çka numri i gjobave ditore nuk mund të jetë më i vogël se pesë, e as më i madh se 360 gjoba ditore. Lartësinë e gjobës ditore gjykata e cakton duke i marrë parasysh mundësitë pasurore dhe personale të kryerësit, duke u nisur nga rregulla e të ardhurave të pastra ditore që kryerësi i realizon ose mund t'i realizojë, si dhe nga obligimet tjera familjare të kryerësit dhe gjendjes së tij pasurore në kohën e sjelljes së aktgjykimit. Vlera më e vogël e gjobës ditore është një euro në kundërvlerë të denarit, kurse më e madhja 5000 euro në kundërvlerë të denarit. Kur dënimi me gjobë shqiptohet si dënim dytësorë përkaj dënimit me burg, gjykata e përcakton në shumë të hollash. Dënimi me gjobë si dënim dytësorë nuk mund të jetë më i vogël se 20 euro në kundërvlerë të denarit, e as më i madh se 5000 euro në kundërvlerë të denarit. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 60) ( Neni 38 ).

Në aktgjykimin përcaktohet afati për pagesën e dënimit me gjobë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë, e as më i gjatë se 3 muaj, por në raste të arsyeshme gjykata mund të lejojë që i dënuari ta paguaj dënimin me gjobë edhe në këste, ashtu që afati i pagesës nuk mund të jetë më i gjatë se dy vjet. Nëse kryerësi është i huaj, atëherë gjykata do të vendos që dënimin me gjobë ta paguaj duke mos e shtyrë, ose do të sigurojë pagesën e tij në mënyrë tjetër. Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë gjykata do të caktojë afat të ri ose nëse vlerëson se i dënuari nuk dëshiron që ta paguajë, atëherë mund të urdhërojë realizim të saj me dhunë në procedurë të përcaktuar me ligj. Nëse dhënia e afatit të ri, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre muaj ose realizimi i dhunshëm mbetin pa sukses, atëherë gjykata do të realizojë ashtu që për çdo gjobë ditore do të përcaktojë një ditë burg, ose kur dënimi me burgim është shqiptuar si dënim dytësorë, për çdo 20 euro të filluara në kundërvlerë të denarit, atëherë do të përcaktojë një ditë burg, me çka burgu nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj. Nëse i dënuari paguan vetëm një pjesë të dënimit me gjobë, atëherë pjesa e lënë proporcionalisht do të shndërrohet në burg, e nëse i dënuari e paguan pjesën tjetër të dënimit me gjobë, atëherë ekzekutimi i burgimit do të ndërpritet. Pas vdekjes së të dënuarit, dënimi me gjobë nuk do të ekzekutohet. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 61) ( Neni 38 a )

#### *Ndalesë për të ushtruar profesion, veprimtari apo detyrë*

Gjykata mundet që kryerësit që i ka shqiptuar dënim me burgim ose dënim me kusht me të cilin është përcaktuar dënim me burgim, t'i ndalojë kryerje të profesionit apo veprimtarisë së caktuar, të detyrës ose punëve që kanë të bëjnë me fitimin, dispozicionimin, shfrytëzimin, menaxhimin ose drejtimin me pasurinë apo për ruajtjen e asaj pasurie, nëse ka keqpërdorur profesionin, veprimtarinë apo detyrën e vet për shkak të kryerjes së veprës penale dhe nëse në bazë të natyrës së veprës të kryer dhe rrethanave nën të cilat është kryer, mund të pritët se veprimtarinë e tillë do ta keqpërdorë për kryerje të sërishme të veprës penale. Dënimi ka të bëjë edhe me ndalimin për të kryer detyrë personi zyrtar, personi përgjegjës në personin juridik apo personi që kryen punë në interes publik.

Në rastet e parapara me ligj mund të parashihet shqiptim i obligueshëm të ndalimit bashkë me dënimin me burg, kur kryerësit i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku 6 muaj. Gjykata e përcakton zgjatjen e ndalimit e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se një e as më e gjatë se 10 vjet, duke e llogaritur edhe ditën e plotfuqishmërisë së vendimit, me çka koha e kaluar në burg nuk llogaritet në kohën e zgjatjes së saj. Gjatë shqiptimit të lirimit me kusht, gjykata mund të përcaktojë se ai do të revokohet, nëse kryerësi e shkel ndalesën për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 62) ( Neni 38 b )

#### *Ndalesë për të drejtuar automjetin*

Kryerësit të veprës penale me të cilën rrezikohet komunikacioni publik, gjykata do t'i shqiptojë ndalim për të drejtuar automjetin të tipit apo kategorisë së caktuar, nëse gjenë se rrethanat nën të cilat është kryer vepra ose shkelja e mëparshme e rregullave të komunikacionit tregojnë se kryerësi mundet sërish të kryejë një vepër të tillë. Gjatë shqiptimit të dënimit gjykata mund të caktojë që ta merr patent shoferin ose të ndalohet lëshim të patent shoferit të kryerësit përderisa zgjatë ndalesa. Gjykata do ta shqiptojë dënimin nëse vepra është kryer në gjendje të dehur. Gjykata e përcakton zgjatjen e ndalesës, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se 3 muaj, e as me e gjatë se 5 vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit, me çka koha e kaluar në burg nuk llogaritet në zgjatjen e saj. Kur kryerësi për nga profesioni është shofer i automjetit, atëherë zgjatja e ndalesës nuk mund të jetë më e shkurtër se 1 e as me e gjatë se 10 vjet. Nëse dënimi i është shqiptuar personit i cili ka leje të huaj për të drejtuar automjetin, atëherë ajo e përfshinë ndalesën e shfrytëzimit në territorin e Republikës së Maqedonisë. Gjatë shqiptimit të lirimit me kusht, gjykata mund të përcaktojë se ai do të revokohet nëse kryerësi e shkel ndalimin për të drejtuar automjetin. Gjatë shqiptimit të dënimit ndalesë për të drejtuar automjetin si dënim i vetëm, gjykata njëkohësisht do të caktojë edhe dënim me gjobë ose dënim me burg që do të kryhet nëse kryerësi e shkel ndalesën. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 63) ( Neni 38 c ).

### *Dëbim i të huajit nga vendi*

Gjykata mundet që kryerësit i cili nuk është shtetas i Republikës së Maqedonisë t'i shqiptojë dënim dëbim nga vendi, kur do të vlerësojë se natyra e veprës, motivi i kryerësit dhe rrethanat nën të cilat është kryer sugjerojnë në qëndrim të mëtutjeshëm të padëshiruar të kryerësit në vend. Dënimi mund të zgjasë prej një deri në 10 vjet ose përherë dhe fillon nga dita e dëbimit të kryerësit nga territori i Republikës së Maqedonisë. Dënimi nuk mund ti shqiptohet kryerësit i cili gëzon mbrojtje që është në pajtim me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 64) ( Neni 38 ç )

### *Ndalesë për vizitimin e ndeshjeve sportive*

Dënimi ndalesë për vizitimin e të gjitha apo të ndeshjeve të caktuara sportive, gjykata do ta shqiptojë për vepra të dhunës në ndeshje sportive në kohëzgjatje prej një deri në tre vjet. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 64) ( Neni 38 d )

Sipas Ligjit, Ministria e Brendshme mban shënime për tifozët të cilëve u është ndaluar hyrja dhe pjesëmarrja në të gjitha ose ndeshjet e caktuara sportive. Gjykata kompetente njofton federatat kombëtare të sporteve për vendimin përfundimtar që vendos për ndalimin e vizitimit të ndeshjeve sportive. Ata janë të detyruar të informojnë organizatorin e konkursit sportiv për tifozët që janë dënuar, si dhe klubin sportiv nëse ata persona janë tifozët e tij të regjistruar.

Organizatori i ndeshjes sportive, nga ana tjetër, është i detyruar të marrë të gjitha masat për të parandaluar hyrjen në objektin sportiv të tifozit që ai e din ose është i detyruar të dijë se i është ndaluar të marrë pjesë në ndeshje. (Правдико, 2014)

Personi të cilit i është shqiptuar dënim për ndalim të ndjekjes së ndeshjeve sportive është i obliguar që më së voni dy orë para fillimit të ndeshjes sportive të vijë dhe të qëndrojë në stacionin policor kompetent sipas vendbanimit apo vendqëndrimit gjatë kohës së ndeshjes sportive dhe një orë pas përfundimit të ndeshjes sportive. (СЕБЕРНА, 2019, f. 82)( Neni 271, paragrafi 4)

Sipas statistikave të vitit 2018, kjo ndalesë është shqiptuar vetëm ndaj 3 personave edhe atë në Gjykatën Themelore Shkupi 1. (Krsteva & Krstev, 2019, p. 4)

## 1.2 Masat alternative

Qëllimi i masave alternative është që ndaj kryerësit me përgjegjësi penale të mos zbatohet dënimi për vepra më të vogla kur ajo nuk është e domosdoshme për shkak të mbrojtjes penalo-juridike dhe kur mund të pritët se qëllimi i ndëshkimit mund të realizohet me paralajmërim, me kërcënim për dënim ( lirim me kusht ), vetëm me paralajmërim ( vërejtje gjyqësore ) ose me masa të ndihmës dhe mbikëqyrjes së sjelljes të kryerësit në liri. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 72) ( Neni 48 )

Kryerësve të veprave penale mund tu shqiptohen këto masa alternative:

1. dënimi me kusht
2. dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse
3. ndërprerje me kusht e procedurës penale
4. punë në dobi të përgjithshme
5. vërejtje gjyqësore dhe
6. burgim shtëpiak. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 72) ( Neni 48 a )

### *Dënimi me kusht*

Me dënimin me kusht kryerësit të veprës penale gjykata ia cakton dënimin dhe njëkohësisht përcakton se ai nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari gjatë kohës që do ta përcaktojë gjykata, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një vit e as më i gjatë se pesë vjet ( koha e kontrollit ) nuk kryen veprë të re penale. Gjykata mund që në dënimin me kusht të përcaktojë se dënimi do të ekzekutohet edhe nëse i dënuari në afat të caktuar nuk e kthen dobinë pasurore e fituar me kryerje të veprës penale, nuk e kompenson dëmin që e ka shkaktuar me veprën penale ose nuk i plotëson obligimet tjera të parapara në dispozitat penalo-juridike. Masat e sigurisë të



shqiptuara me dënimin me kusht ekzekutohen. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 73) ( Neni 49 )

Dënimi me kusht mund të shqiptohet kur kryerësit i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje deri në dy vjet apo dënimi me gjobë. Gjatë vendosjes se a do të shqiptohet dënimi me kusht, duke pasur kujdes për qëllimin e dënimit me kusht, gjykata posaçërisht do ta marrë parasysh personalitetin e kryerësit, jetën e tij të mëparshme, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra. Nëse kryerësit i është caktuar edhe dënimi me burgim edhe dënimi me gjobë, dënimi me kusht mund të shqiptohet për të dy dënimet ose vetëm për dënimin me burgim. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 73) ( Neni 50 )

Gjykata do ta tërheqë dënimin me kusht nëse i dënuari gjatë kohës së kontrollimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënim me burgim prej dy vjetësh ose me kohëzgjatje më të madhe. Nëse gjatë kohës së kontrollimit i dënuari kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënim me burgim më pak se dy vjet apo dënim me gjobë, gjykata pasi t'i vlerësojë të gjitha rrethanat që u përkasin veprave të kryera penale dhe kryerësit, e veçmas ngjashmërinë e veprave penale, rëndësinë e tyre dhe motivet nga të cilat janë kryer, do të vendos se a do ta revokojë dënimin me kusht. Nëse e tërheq dënimin me kusht, gjykata do të jap një ndëshkim të vetëm edhe për veprën penale të bërë më herët edhe për veprën e re penale, duke e marrë ndëshkimin e dënimit me kusht të tërhequr si të vërtetuar. Nëse nuk e revokon dënimin me kusht, gjykata për veprën e re penale të kryer mund të shqiptojë dënim me kusht apo dënim. Nëse gjykata vërteton se edhe për veprën e re penale duhet të shqiptojë dënim me kusht, do të caktojë një dënim të vetëm edhe për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale dhe do të përcaktojë kohë të re për kontrollim, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit e as më e gjatë se pesë vjet, duke llogaritur prej ditës së plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ri. Të dënuarit të cilit për veprën e re penale do t'i shqiptohet burgim, koha e kaluar në vuajtje të këtij dënimi do t'i llogaritet në kohën e kontrollimit të caktuar me dënimin me kusht. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 74) ( Neni 51 )

Gjykata do ta revokojë dënimin me kusht nëse pas shqiptimit të tij vërteton se i dënuari ka kryer vepër penale para se të dënohet me kusht dhe nëse vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të ishte ditur për atë vepër. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 75) ( Neni 52 )

Nëse me dënimin me kusht të dënuarit i është caktuar përmbushja e ndonjë detyrimi, kurse ai nuk e përmbush atë detyrim në afat të caktuar në aktgjykim, gjykata në suaza të afatit për kontrollim mund ta vazhdojë afatin e plotësimit të detyrimit ose mund ta revokojë dënimin me kusht dhe ta shqiptojë dënimin e caktuar në dënimin me kusht. Nëse vërteton se i dënuari për shkaqe të arsyeshme nuk mund ta përmbush detyrimin e caktuar, gjykata do ta lirojë nga përmbushja e atij detyrimi ose do ta ndërrojë me ndonjë detyrim tjetër përkatës të paraparë me ligj. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 75) ( Neni 53 )

Dënimi me kusht mund të tërhiqet gjatë kohës së kontrollimit. Nëse i dënuari në atë kohë kryen vepër penale që kërkon revokim të dënimit me kusht, ndërsa kjo me aktgjykim është caktuar bile pas kalimit të kohës për kontrollim, dënimi me kusht mund të revokohet më së voni në afat prej një viti nga dita kur ka kaluar koha për kontrollim. Nëse i dënuari në afatin e caktuar nuk përmbush ndonjë detyrim, gjykata mundet që më së voni në afat prej një viti prej ditës kur ka kaluar afati i kontrollimit, mund të caktojë ekzekutimin e dënimit të përcaktuar në dënimin me kusht. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 76) ( Neni 54 )

#### *Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse*

Mbikëqyrje mbrojtëse gjykata do të caktojë kur do të bindet se dënimi me kusht nuk do të ndikojë mjaft ndaj kryerësit që të mos kryejë më vepra penale, ndërsa rrethanat lidhur me personalitetin e kryerësit apo mjedisit në të cilin jeton e bëjnë të arsyeshëm pritjen se qëllimi i dënimit me kusht do të arrihet nëse caktohen masat të ndihmës, kujdesit, mbikëqyrjes ose mbrojtjes. Zgjatja e mbikëqyrjes mbrojtëse gjykata e cakton në suaza të kohës së caktuar të kontrollimit. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 76) ( Neni 55 )

Gjatë shqiptimit të mbikëqyrjes mbrojtëse gjykata mund t'i caktojë të dënuarit një ose disa nga detyrimet vijuese:

- 1) aftësim, profesionalizim e rikualifikim që të mundet i dënuari ta mbajë vendin e punës që e zë ose të krijohen prezumime për punësim,
- 2) pranim të punësimit që i përgjigjet aftësive dhe prirjes së të dënuarit,
- 3) vizitimi i programit për punë me të dënuar për vepra penale të kryera gjatë kryerjes së dhunës familjare,
- 4) realizimi i obligimeve për mirëmbajtje të familjes, ngritje të fëmijëve dhe të obligimeve të tjera familjare,
- 5) mundësim të shikimit dhe këshillave lidhur me shpërndarjen dhe harxhimin e mjeteve të rrogës dhe të të hyrave tjera që i sendërton,
- 6) mos vizitimi i disa llojeve të lokaleve apo vendeve të tjera ku toçitet pije alkoolike ose luhën lojëra fati,
- 7) ndalim të përdorimit të pijeve alkoolike, të drogave dhe të substancave të tjera psikotrope,
- 8) shfrytëzimi i kohës së lirë sipas vlerësimit të organit social,
- 9) shmangia dhe mos shoqërimi me persona që ndikojnë negativisht ndaj të dënuarit dhe
- 10) nënshtrim të mjekimit dhe rehabilitimit social në institucione të specializuara përkatëse.

Gjatë zgjedhjes së llojit të obligimit, gjykata do të ketë parasysh, para së gjithash personalitetin e kryerësit, gjendjen e tij shëndetësore dhe cilësitë psikike, moshën, kushtet materiale dhe familjare, rrethanat në të cilat e ka kryer veprën, motivet e kryerjes së veprës dhe rrethanat e tjera lidhur me personalitetin e kryerësit që janë me rëndësi gjatë zgjedhjes së llojit të obligimit, duke mbajtur llogari të mos fyhet dinjiteti njerëzor e as të shkaktohen vështirësi të panevojshme në riedukimin e tij. Gjatë kohës deri sa zgjatë pezullimi me kusht të ekzekutimit të dënimit të caktuar, gjykata me propozim të organit social të personit të dënuar, mund ta zëvendësojë obligimin e caktuar me ndonjë tjetër ose ta heq. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 77) ( Neni 56 )

Nëse i dënuari me kusht nuk i përmbush obligimet e caktuara, gjykata mund ti bëjë vërejtje për përmbushjen e obligimit të caktuar ose atë ta zëvendësojë me një tjetër. Nëse i dënuari edhe më tutje nuk i përmbush obligimet e caktuara, gjykata në suaza të kohës për kontrollim mund ta vazhdojë zgjatjen e mbikëqyrjes mbrojtëse ose ta revokojë dënimin me kusht. Nëse pas plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është caktuar mbikëqyrja mbrojtëse kalojnë më shumë se gjashtë muaj, kurse mbikëqyrja nuk ka filluar, gjykata do të vendosë përsëri për nevojën e ekzekutimit të tij. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 78) ( Neni 58 )

#### *Ndërprerja me kusht e procedurës penale*

Për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo dënim me burgim deri në një vjet, gjykata mund të vendosë që pas marrjes në pyetje të të pandehurit dhe dëgjimit dhe pëlqimit të të dëmtuarit që ta ndërpres procedurën penale me kusht që kryerësi në afat në të cilin zgjat ndërprerja e procedurës të mos kryej vepër e re penale. Procedura mund që me vendim gjyqësorë të ndërpritet më së tepërmi në afat prej një viti. Afati i ndërprerjes së procedurës nuk llogaritet në afatin e parashkrimit të ndjekjes penale. Nëse kryerësi në afatin e kontrollimit nuk kryen vepër të re penale ose nëse në atë afat nuk zbulohet ndonjë vepër më parë e kryer, atëherë procedura ndërpritet. Gjatë marrjes së vendimit për zbatimin e kësaj mase, gjykata do ta merr parasysh veçanërisht pendimin dhe ndjesën e shprehur e kryerësit, se a ka bërë mënjanimin e pasojave të veprës dhe kompensimin i dëmit i shkaktuar me veprën penale. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 79) ( Neni 58 a )

Ndërprerja me kusht e procedurës penale nuk është shqiptuar asnjëherë që nga viti 2009 e deri në vitin 2018. (Krsteva & Krstev, 2019, p. 5)

#### *Puna në dobi të përgjithshme*

Për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në tre vjet, gjykata mundet që në pajtim me kryerësin t'i shqiptojë masë për punë në dobi të përgjithshme

në liri, nëse vepra është kryer në kushte të veçanta lehtësuese, kurse kryerësi më parë nuk ka qenë i dënuar.

Masa shqiptohet në kohëzgjatje prej 40 deri 240 orë, me çka i dënuari është i obliguar t'i punojë pa kompensim në organ shtetërore, ndërmarrje publike, institucion publik apo organizatë humanitare gjatë festave shtetërore, ditëve të të shtunave dhe të dielave dhe jo më shkurt se 5 orë në javë, në periudhë më së tepërmi prej 12 muajsh. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme shëndetësore, personale dhe familjare, gjykata mundet ta vazhdojë ekzekutimin e masës së paku edhe për gjashtë muaj. Kur gjykata do të shqiptojë dënim me gjobë deri në 90 gjoba ditore apo 1800 euro në kundërvlerë të denarit apo dënim me burgim deri në tre muaj, mundet që njëkohësisht me kërkes të të dënuarit të vendosë për zëvendësim të dënimit me punë në dobi të përgjithshme, me çka një ditë burg, gjobë ditore apo 20 euro në kundërvlerë të denarit zëvendësohen me tre orë punë në dobi të përgjithshme me çka shuma e përgjithshme e orëve të mos tejkalojë 240 orë. Nëse i dënuari nuk i plotëson apo në mënyrë jo të rregullt i plotëson obligimet e veta të punës, gjykata me shkrim do t'ia tërheqë vërejtjen, e nëse ai vazhdon me sjelljen e tillë, atëherë gjykata mund të vendosë që ta rrisë numrin e orëve apo ta vazhdojë ekzekutimin e masës për më shumë se tre muaj, nëse për të ekzistojnë shkaqe të arsyeshme apo ta zëvendësojë pjesën e pa plotësuar të masës me dënim me gjobë apo me burgim. Nëse i dënuari nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, e shqiptuar si zëvendësim për dënimin me gjobë apo me burgim, gjykata merr vendim për ekzekutimin e dënimit të shqiptuar. Obligimi i punës që kryerësi e ka plotësuar llogaritet në dënimin, me çka për çdo tre orë punë në dobi të përgjithshme llogaritet një ditë burgim apo një gjobë ditore apo 20 euro në kundërvlerë të denarit. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 80) ( Neni 58 b )

Kur aktgjykimi për shqiptimin e masës alternative përkatëse është marrë duke u pajtuar paraprakisht i pandehuri me propozimin e shqiptimit të masës , konsiderohet se palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë. (Sahiti & Zejneli, 2017, p. 336)

*Vërejta gjyqësore*

Vërejtje gjyqësore mund të shqiptohet për veprat penale për të cilat është caktuar dënim me burgim deri në një vit ose dënim me gjobë, që janë kryer në rrethana të tilla lehtësuese të cilat i bëjnë veçanërisht të lehta. Për disa vepra penale dhe në kushte të caktuara me ligj mund të shqiptohet vërejtje gjyqësore edhe kur është caktuar dënim me burgim deri në tre vjet.

Gjykata mund të shqiptojë vërejtje gjyqësore për më shumë vepra penale të kryera në bashkim, nëse për çdonjërin nga ato vepra ekzistojnë kushte. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 81) ( Neni 59 )

### *Burgim shtëpiak*

Nëse kryerësi i veprës penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në një vjet është i vjetër dhe i paaftë, rëndë i sëmurë apo është grua shtatzëne, gjykatësi mund t'i shqiptojë dënim me burgim dhe njëkohësisht të vendos që me pëlqimin e tij dënimin ta vuaj në burgim shtëpiak. Gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me burgim me burgim shtëpiak nëse ekzistojë kushte me mjete bashkëkohore elektronike apo të telekomunikacionit që të kontrollohet ekzekutimi i burgimit shtëpiak që përbëhet nga ndalesa për braktisjen e shtëpisë nga i dënuari. Nëse i dënuari e shkel ndalesën për braktisje të shtëpisë, gjykata mund të caktojë që dënimi i zëvendësuar me burgim të ekzekutohet në tërësi në institucion për ekzekutimin e dënimit me burgim. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 82) ( Neni 59 a )

Burgimi shtëpiak njëjtë si edhe Ndërprerja me kusht e procedurës penale nuk është shqiptuar asnjëherë në periudhën brenda viteve 2009-2018 (Krsteva & Krstev, 2019, p. 5), edhe pse në një lajm të botuar në vitin 2016 thuhet se: "Drejtoria për kryerjen e sanksioneve është furnizuar me 400 hallka elektronike për vëzhgimin e të dënuarve që do të vuajnë burg shtëpiak. Nga Drejtoria për kryerjen e sanksioneve thonë se tanimë janë porositur pajisjet për vëzhgim elektronik, monitorë dhe softuer ndërsa është trajnuar edhe kuadro i cili do të punoj me ta dhe do ta realizoj burgun shtëpiak. Megjithatë, kur do të sillen aktgjykimi i parë dhe kujt do t'i shqiptohet masa e burgut shtëpiak me hallkë elektronike, ngel e pasigurt." (Alsat-m, 2016)

### 1.3 Masat e sigurisë

Qëllimi i masave të sigurisë është që të mënjanohet gjendja dhe kushtet të cilat mund të ndikojnë që kryerësi në të ardhmen të kryejë vepra penale. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 84) ( Neni 60 )

Kryerësve të veprave penale mund t’u shqiptohen këto masa të sigurimit:

- 1) mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësorë,
- 2) mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri,
- 3) mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe i narkomanëve dhe
- 4) mjekimi medicinalo-farmakologjik i kryerësve të sulmeve seksuale ndaj fëmijës deri në 14 vjet. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 84) ( Neni 61 )

Kryerësit të veprës penale gjykata mund t’i shqiptojë një apo më shumë masa sigurimi kur ekzistojnë kushte për shqiptimin e tyre të parapara me këtë kod. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në institucionin shëndetësorë dhe mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri, i shqiptohen kryerësit të papërgjegjshëm të veprës penale në mënyrë të pavarur. Me vendimin për shqiptimin e masave, gjykatësi mund të përcaktojë ndalesë të përkohshme për të ushtruar profesion, veprimtari dhe detyrë, ose ndalesë për të drejtuar automjetin, të cilët zgjasin për derisa zgjat zbatimi i masave. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësorë dhe mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri i shqiptohen kryerësit, përgjegjshmëria e së cilit në esencë është e zvogëluar nëse i është shqiptuar dënim me burg, lirim me kusht me të cilën është përcaktuar dënimi me burg ose lirim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve mund të shqiptohen nëse kryerësit i është shqiptuar dënim, lirim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, vërejtje gjyqësore ose lirim nga dënimi. Mjekimi medicinalo-farmakologjik mund t’i shqiptohet kryerësit për sulm

seksual ndaj fëmijës deri në moshën 14 vjet, nëse i është shqiptuar dënim me burgim. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 84) ( Neni 62 )

#### *Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësorë*

Kryerësit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të papërgjegjshmërisë apo përgjegjshmërisë esencialisht të zvogëluar, gjykata do ti caktojë mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësorë, nëse vërteton se për shkak të asaj gjendjeje ka nevojë për mjekimin e tij dhe ruajtje në institucion të tillë. Masën gjykata do ta ndërpres kur do të vërtetojë se nuk ka më nevojë për mjekim dhe ruajtjen të kryerësit në institucion shëndetësorë. Kryerësi i cili ka kryer vepër penale në gjendje të përgjegjshmërisë esencialisht të zvogëluar dhe që është dënuar me burgim, koha e kaluar në institucion shëndetësorë llogaritet në kohën e zgjatjes së ndëshkimit të dhënë. Nëse ajo kohë është më e shkurtër se zgjatja e dënimit të dhënë, gjykata mund të caktojë i dënuari të udhëzohet në vuajtje të pjesës së mbetur të dënimit ose të lëshohet në lirim me kusht. Gjatë vendosjes për lirim me kusht gjykata posaçërisht do të marrë parasysh suksesin e mjekimit të të dënuarit, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucion shëndetësorë dhe pjesën e mbetur të dënimit që i dënuari nuk e ka vuajtur. Gjkata çdo vit e rishqyrton nevojën e mjekimit dhe të ruajtjes së kryerësit në institucion shëndetësorë. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 85) ( Neni 63 )

#### *Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri*

Kryerësit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të papërgjegjshmërisë, gjykata do t'i caktojë mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri, nëse vërteton se për shkak të gjendjes së tillë përsëri mund të kryejë vepër penale, kurse për shmangien e këtij rreziku mjafton mjekimi i tij në liri. Masa mund t'i shqiptohet kryerësit të papërgjegjshëm ndaj të cilit është caktuar mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësorë, kur gjykata në bazë të rezultateve të mjekimit do të vërtetojë se më nuk ka nevojë për ruajtje dhe mjekim të tij në institucion shëndetësorë por vetëm në liri. Gjkata mund t'i caktojë mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri edhe kryerësit, përgjegjshmëria e të cilit esencialisht është e zvogëluar dhe është lëshuar në lirim me kusht. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri kur i shqiptohet kryerësit, përgjegjshmëria e së cilit është esencialisht e zvogëluar nuk mund të zgjasë më



shumë se dy vjet. Kryerësit, përgjegjshmëria e të cilit është esencialisht e zvogëluar dhe i cili është i dënuar me dënim me burgim, koha e kaluar në mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri nuk i llogaritet në dënim.

Nëse kryerësi nuk i nënshtrohet mjekimit në liri ose nëse e lë atë në kokë të vet ose nëse janë krijuar kushte të shqiptimit të masës së mjekimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjes në institucion shëndetësorë , atëherë gjykata mund ta zëvendësojë me atë masë. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 86) ( Neni 64 )

#### *Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve*

Kryerësit të veprës penale për shkak të varësisë së përdorimit të përhershëm të pijeve alkoolike, të drogave dhe të substancave të tjera psikotrope, kur ekziston rrezik për shkak të kësaj varësie edhe më tutje të kryejë vepra penale, gjykata mund t'i caktojë mjekim të detyrueshëm. Masa zbatohet në institucion për ekzekutimin e dënimit ose në institucion shëndetësorë apo institucion tjetër të specializuar. Koha e kaluar në institucion të tillë llogaritet në dënimin. Gjatë shqiptimit të dënimit me kusht gjykata mund t'i urdhërojë kryerësit mjekim në liri, nëse kryerësi pajtohet t'i nënshtrohet mjekimit të tillë. Nëse kryerësi pa shkaqe të arsyeshme nuk i nënshtrohet mjekimit në liri apo në kokë të vet e lë mjekimin, gjykata mund të caktojë të revokohet dënimi me kusht ose masa e mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve të zbatohet me dhunë në institucion shëndetësorë ose institucion tjetër të specializuar. Nëse kjo masë është shqiptuar me dënimin, përveç dënimit me burgim, ose me lirim me kusht, lirim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, vërejtje gjyqësore ose lirim nga dënimi, mund të zgjasë më së shumti dy vjet. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 87) ( Neni 65 )

#### *Mjekimi medicinalo-farmakologjik*

Kryerësit për vepër penale sulm seksual ndaj fëmijës deri në 14 vjet, kur ekziston rreziku që edhe më tutje të kryej vepra të tilla, gjykata mund t'i shqiptojë masë të mjekimit medicinalo-farmakologjik. Nëse për veprën është paraparë dënim me burgim të përjetshëm, gjykata mundet që kryerësit t'i shqiptojë dënim me burgim prej 40 vjet nëse ai pajtohet me mjekimin

medicinalo-farmakologjik, i cili do të zgjasë deri në fund të jetës së tij ose deri në kohën, në të cilën sipas vlerësimit të gjykatës është i nevojshëm të zgjatë mjekimi. Nëse për veprën është paraparë dënim me burgim afatgjatë prej 40 vjet, gjykata mundet që kryerësit t’i shqiptojë dënim me burgim prej 20 vjet nëse ai pajtohet me mjekimin medicinalo-farmakologjik, i cili do të zgjasë deri në fund të jetës së tij ose deri në kohën në të cilën sipas vlerësimit të gjykatës është i nevojshëm.

Nëse për veprën është paraparë dënim me burgim prej 20 vjet, gjykata mundet që kryerësit t’i shqiptojë dënim minimal me burgim i paraparë për veprën penale nëse ai pajtohet me mjekimin medicinalo-farmakologjik, i cili do të zgjas deri në fund të jetës së tij ose deri në kohën, në të cilën sipas vlerësimit të gjykatës është i nevojshëm të zgjas mjekimi. Masa ekzekutohet në liri në institucione të specializuara shëndetësore pas vuajtjes së dënimit me burgim. Nëse kryerësi nuk i nënshtrohet masës mjekimi medicinalo-farmakologjik ose vetvetiu e braktis mjekimin, gjykata mund të përcaktojë që masa në mënyrë të detyrueshme të ekzekutohet në institucion shëndetësor ose në institucion tjetër të specializuar. Me përjashtim, gjykata mundet që edhe pa pajtim të kryerësit detyrimisht do t’ia shqiptojë masën nëse kryerësi veprën e ka kryer në përsëritje ( recidivizëm ). Masa mjekimi medicinalo-farmakologjik do të zgjas deri në fund të jetës së kryerësit ose deri në kohën, në të cilën sipas vlerësimit të gjykatës është i nevojshëm të zgjas mjekimi. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 88) ( Neni 65 a )

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale- Dime Spasov tha se trajtimi aplikohet në SHBA dhe vende të tjera dhe nuk është i rezikshëm për shëndetin e personi, si dhe përbëhet nga një injeksion që duhet të meret çdo 6 muaj. (RMV, 2013)

## 2. Sanksionet penale në Republikën e Kosovës

### 2.1 Dënimet kryesore

Llojet e dënimeve kryesore janë:

1. dënimi me burgim të përjetshëm;
2. dënimi me burgim dhe
3. dënimi me gjobë. (Republika, 2019, p. 10) ( Neni 40 )

Qëllimet e dënimit janë:

1. të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij;
2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale;
3. të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe
4. të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. (Republika, 2019, p. 9) ( Neni 38 )

#### *Dënimi me burgim të përjetshëm*

Ligji mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda. Ligji nuk mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm si të vetmin dënim kryesor për një vepër të veçantë penale. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur njëzetënjë (21) vjet ose personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. (Republika, 2019, p. 10) ( Neni 41 )

Që nga hyrja në fuqi e Kodit Penal, më 1 janar 2013 e deri më sot, janë shqiptuar tre dënime me burgim të përjetshëm, në Kosovë. Dënimet janë shqiptuar nga tri Gjykata në Kosovë, Gjykata Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Gjakovë. Kështu ka thënë zëdhënësja e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës (KGJK), Ajshe Qorraj. (Boletini, 2019)

#### *Dënimi me burgim*

Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se tridhjetë (30) ditë e as më tepër se njëzet e pesë (25) vjet. Për vepra penale për të cilat ligji parasheh dënim me burgim të përjetshëm, gjykata mund të shqiptoj dënim me burgim deri në tridhjetë e pesë (35) vjet. Dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe në muaj të plotë, e në rastet kur dënimi është deri në gjashtë (6) muaj, dënimi shqiptohet në ditë të plota. (Republika, 2019, p. 10) ( Neni 42 )

#### *Dënimi me gjobë*

Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) Euro evropiane. Dënimi me gjobë nuk mund të tejkalojë njëzet e pesëmijë (25.000) Euro ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë pesëqind mijë (500.000) Euro. Në aktgjykim caktohet afati i pagesës së dënimit me gjobë. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se tre (3) muaj, mirëpo në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë që dënimi me gjobë të paguhet me këste për një periudhë që nuk tejkalon dy (2) vjet. Aktgjykimi po ashtu duhet të përcaktojë se kur duhet të paguhet këstet dhe duhet të cek se mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e personit të dënuar, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzet (20) Euro gjobë. Kohëzgjatja e punës në dobi të përgjithshme nuk mund të tejkalojë dyqind e dyzet (240) orë pune. Dënimi me gjobë nuk ekzekutohet pas vdekjes së personit të dënuar. (Republika, 2019, pp. 10-11) ( Neni 43 )

### **Zëvendësimi i dënimit me burgim me dënim me gjobë**

Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, gjykata nuk kufizohet me shkallën e përlogaritjes të përcaktuar në nenin 43 paragrafi 3. (Republika, 2019, p. 11) ( Neni 44)

### **Zëvendësimi i dënimit me burgim me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme**

Gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund të zëvendësojë dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Nëse e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një periudhë të caktuar kohore prej tridhjetë (30) deri në dyqind e dyzet (240) orë pune. Puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet brenda kohës së caktuar nga gjykata dhe kjo kohë nuk mund të jetë me gjatë se një (1) vit. 4. Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer. (Republika, 2019, pp. 11-12) ( Neni 45 )

## 2.2 Dënimet plotësuese

Dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor ose alternativ.

Dënimet plotësuese janë:

- 1) heqja e të drejtës për t'u zgjedhur;
- 2) urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit;
- 3) ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik;

- 4) ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës;
- 5) ndalimi i drejtimit të automjetit;
- 6) marrja e lejes së vozitjes;
- 7) urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe
- 8) dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.

Dënimi plotësues me ndalimin e drejtimit të automjetit mund të shqiptohet së bashku me dënimin me kusht, me vërejtjen gjyqësore ose me lirimin nga dënimi. (Republika, 2019, p. 17) ( Neni 59 )

#### *Heqja e të drejtës për t’u zgjedhur*

Gjykata ia heq kryesit të veprës penale të drejtën për tu zgjedhur prej një (1) deri në katër (4) vjet, nëse ai person, me qëllim që të zgjidhet, kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku dy (2) vjet burgim. (Republika, 2019, p. 17) ( Neni 60 )

#### *Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit*

Kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale. Dëmshpërblimi përfshin vlerën e shpenzimeve që janë të barabarta me vlerën e çfarëdo pasurie të vjedhur, humbur, dëmtuar apo shkatërruar. Dëmshpërblimi do të urdhërohet gjithashtu edhe për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat viktimi i përjeton si rezultat i veprës penale dhe procedurave hetimore dhe gjyqësore lidhur me atë vepër. (Republika, 2019, p. 17) ( Neni 61 )

#### *Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik*

Gjykata ia ndalon kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në pesë (5) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi i tillë ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim. Gjykata mund t’ia ndalojë kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në

tre (3) vjet, nëse personi i tillë i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht. Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat që përfshihen në Kapitullin XXXIII të këtij Kodi ( Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare ).

Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo në shërbime publike prej një (1) deri në pesë (5) vjet, nëse i njëjti është dënuar për dhunë në familje. Kur personi zyrtar dënohet me burgim efektiv, ndalesa e tillë ekzekutohet vetëm pas mbajtjes së dënimit me burgim. Për dënimin me kusht apo me gjobë, ndalesa në ushtrimin e funksionit në administratë publike apo në shërbime publike fillon të zbatohet në momentin që aktgjykimi merr formën e prerë. (Republika, 2019, pp. 17-18) ( Neni 62 )

#### *Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës*

Gjykata mund t’ia ndalojë kryesit të veprës penale ushtrimin e profesionit të caktuar, veprimtarisë së pavarur, detyrës menaxhuese apo administrative ose detyrave që janë të lidhura me sistemimin, menaxhimin apo shfrytëzimin e pasurisë në pronësi publike apo mbrojtjen e pasurisë së tillë, nëse ai person e ka keqpërdoruar pozitën e tij, veprimtarinë apo detyrën me qëllim të kryerjes së veprës penale ose nëse ka arsye të pritët që ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale. Gjykata e cakton kohëzgjatjen e dënimit, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) vit e as më i gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatje të këtij dënimi. Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata mund të vendosë që ky dënim me kusht të revokohet nëse kryesi nuk e respekton ndalesën e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës. Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e profesionit, aktivitetit të pavarur, të detyrës menaxhuese apo administrative prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat në Kapitullin XXXIII të këtij Kodi ( Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare ). Gjykata ia shqipton kryesit të veprës penale, ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës që përfshin kontaktin e rregullt me fëmijë.

Gjykata mund ta shqiptoj këtë dënim në kohëzgjatje të përjetshme, i cili i nënshtrohet shqyrtimit periodik gjyqësor nga gjykata pas skadimit të dhjetë (10) vjetëve nga fillimi i ekzekutimit të masës së shqiptuar. Gjykata mund ta ndalojë ekzekutimin e saj me propozim të personit të dënuar nëse ka vërtetuar se arsyet për ndalimin nuk ekzistojnë më.

Personi i dënuar mund të paraqes përsëri propozimin e tij apo të saj, por jo më herët se një (1) vit pas shqyrtimit të mëparshëm. (Republika, 2019, p. 18) ( Neni 63 ).

#### *Ndalimi i drejtimit të automjetit*

Kryesit të veprës penale, i cili rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar. Gjykata cakton kohëzgjatjen e dënimit, kohëzgjatja e të cilit nuk mund të jetë më e shkurtë se një (1) vit e as më e gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e kaluar në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi. Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata mund të vendosë që dënimi i tillë të revokohet nëse kryesi e shkel ndalesën e drejtimit të automjetit. Ky paragraf nuk zbatohet nëse paraqiten rrethana të jashtëzakonshme të cilat kërkojnë nga kryesi që të drejtojë automjetin. Nëse dënimi i është shqiptuar personit i cili ka leje të huaj për drejtimin e automjetit, ky dënim do të konsistojë në ndalimin për përdorimin e lejes së huaj në territorin e Republikës së Kosovës. (Republika, 2019, pp. 18-19) ( Neni 64 )

#### *Marrja e lejes së vozitjes*

Kryesit të veprës penale që e rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia marrë lejen e vozitjes për llojin apo kategorinë e caktuar të automjetit dhe mund t'ia ndalojë kryesit marrjen e lejes së re gjatë periudhës prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Nëse kryesi nuk ka leje të vozitjes, gjykata ia ndalon kryesit marrjen e lejes së vozitjes brenda afatit prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Gjykata mund të shqiptojë dënimin nëse kryesi ka kryer vepër penale duke shkaktuar lëndim të rëndë trupor apo vdekjen e personit ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e kryesit në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë e trafikut publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit. Leja e vozitjes merret



me vendim të formës së prerë të gjykatës. Koha e mbajtur në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi. Pas skadimit të afatit të caktuar nga gjykata, kryesi mund ta marrë lejen e re të vozitjes sipas kushteve të përgjithshme të parapara për marrjen e lejes përkatëse të vozitjes. (Republika, 2019, p. 19) ( Neni 65 )

#### *Urdhri për publikimin e aktgjytimeve*

Gjykata mund të urdhërojë publikimin e aktgjykimit kur çmon se publikimi është në interes të përgjithshëm, të të dëmtuarit ose të personave të tjerë. Urdhri për publikimin e aktgjykimit kërkon që aktgjykimi të publikohet, tërësisht ose pjesërisht, në gazetë apo të transmetohet në radio ose televizion. Publikimi bëhet me shpenzimet e të dënuarit. Data dhe kohëzgjatja e publikimit caktohen nga gjykata. Gazeta, radiostacioni ose stacioni televiziv e publikojnë aktgjykimin të cilin ua ka dërguar gjykata. Publikimi i aktgjykimit nuk urdhërohet nëse publikimi i tillë e rrezikon fshehtësinë zyrtare, privatësinë e personave apo moralin e shoqërisë. (Republika, 2019, p. 19) ( Neni 66)

#### *Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës*

Gjykata mund të urdhërojë dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Kur gjykata vendos për shqiptimin e dënimit dhe kohëzgjatjen e këtij dënimi, gjykata merr parasysh llojin dhe peshën e veprës penale, motivet e kryerjes së veprës penale dhe lidhjen e kryesit me Republikën e Kosovës. Dënimi nuk shqiptohet nëse ekzekutimi i dënimit është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Kohëzgjatja e dëbimit llogaritet nga dita kur vendimi gjyqësor merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi. (Republika, 2019, pp. 19-20) ( Neni 67 )

## 2.3 Dënimet alternative

Dënimet alternative janë:

- 1) dënimi me kusht;
- 2) gjysmëliria; dhe
- 3) urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata po ashtu mund të shqiptojë:

- 1) urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues; dhe
- 2) urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues. (Republika, 2019, p. 12) ( Neni 46 )

Qëllimi i dënimin me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimin është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale. (Republika, 2019, p. 12) ( Neni 47 )

#### *Dënimi me kusht*

Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më e gjatë se pesë (5) vjet. Në dënimin me kusht, gjykata mund të caktojë që dënimi të ekzekutohet, nëse në afatin e caktuar personi i dënuar nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenson dënimin që e ka shkaktuar me vepër penale ose nuk i përmbush detyrimet e tjera të parapara me dispozitat e këtij Kodi. Gjukata cakton afatin për përmbushjen e këtyre kushteve në kuadër të kohës së verifikimit. Kur gjykata shqipton dënimin me burgim ose dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim. (Republika, 2019, p. 12) ( Neni 48)

#### **Kushtet për shqiptimin e dënimin me kusht**

Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet. Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet,

nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit. Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit nëse gjykata shqipton dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet, qoftë për një veprë penale ose për disa vepra në bashkim. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale.

Kur gjykata shqipton dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim. (Republika, 2019, pp. 12-13) ( Neni 49 )

### **Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprës së re penale**

Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet. Gjykata mund ta revokojë dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim me më pak se dy (2) vjet ose dënimi me gjobë, pasi t’i ketë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat u përkasin veprave penale të kryera si dhe personit të dënuar dhe sidomos ngjashmëritë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre dhe motivet për kryerjen e veprave penale. Kur revokon dënimin me kusht, gjykata shqipton dënimin unik për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale dhe trajton dënimin e revokuar me kusht si të përcaktuar. Nëse gjykata nuk e revokon dënimin me kusht, mund ta shqiptojë dënimin me kusht apo dënimin me burgim ose dënimin me gjobë për veprën e re penale. Nëse gjykata shqipton dënim me kusht për veprën e re penale, gjykata zbaton dispozitat e nenit 76 të këtij Kodi për ta shqiptuar dënimin e bashkuar me kusht për veprën penale të kryer më parë dhe për veprën e re penale dhe po ashtu e cakton një periudhë të bashkuar të verifikimit e cila nuk mund të jetë më pak se një (1) vit e as më shumë se pesë (5) vjet, duke filluar prej ditës kur vendimi për dënimin bëhet i plotfuqishëm. Nëse gjykata shqipton dënim me burgim për veprën e re penale, periudha kohore që kalohet në mbajtjen e dënimit me burgim nuk hiqet nga koha e verifikimit e

vendosur me dënimin me kusht për veprën penale të kryer më parë. (Republika, 2019, p. 13) ( Neni 50 )

### **Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprës penale të kryer më parë**

Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht, me aktgjykim të plotfuqishëm konstaton se personi i dënuar ka kryer një vepër penale tjetër para se të jetë dënuar me kusht dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër penale. (Republika, 2019, p. 13) ( Neni 51 )

### **Revokimi i dënimit me kusht për shkak të mos përbushjes së kushteve**

Nëse dënimi me kusht është kushtëzuar me përbushjen e një apo më shumë kushteve dhe personi i dënuar nuk përbush kushtin apo kushtet brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata mund ta vazhdojë afatin e përbushjes së kushtit brenda afatit të verifikimit apo mund ta revokojë dënimin me kusht dhe ta ekzekutojë dënimin i cili është caktuar me dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se personi i dënuar nuk ka mund ta përbushë kushtin për shkaqe të arsyeshme, gjykata e heq përbushjen e atij kushti ose e zëvendëson atë me një kusht tjetër përkatës të paraparë me ligj. (Republika, 2019, p. 14) ( Neni 52 )

### **Afatet për revokimin e dënimit me kusht**

Dënimi me kusht mund të revokohet gjatë kohës së verifikimit. Nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe kryen vepër penale për të cilën kërkohet revokimi i dënimit me kusht gjatë kohës së verifikimit, mirëpo kjo është konstatuar me aktgjykim të plotfuqishëm vetëm pas skadimit të kohës së verifikimit, dënimi me kusht mund të revokohet jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i kohës së verifikimit. Nëse personi i dënuar brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e përbush kushtin e shqiptuar nga gjykata, gjykata mund të revokojë dënimin me kusht jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i kohës për përbushjen e detyrimit. (Republika, 2019, p. 14) ( Neni 53 )

### **Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues**

Gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose

alkooli, nëse gjykata, pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues, konsideron se faktori kryesor që ka motivuar kryerjen e veprës penale është i lidhur me varësinë e tij nga droga ose alkooli dhe se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale. Gjkata cakton periudhën gjatë së cilës programi për trajtim të detyrueshëm duhet të fillojë dhe të përfundojë. Periudha e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të jetë më pak se tre (3) muaj apo më tepër se dymbëdhjetë (12) muaj. Dënimi konsiderohet se është mbajtur me kryerjen e suksesshme të programit të trajtimit rehabilitues siç kërkohet nga shërbimi sprovues.

Nëse personi i dënuar largohet nga programi i trajtimit rehabilitues, nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk i përmbush detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim, gjykata mund të zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyj kohëzgjatjen e urdhrit për trajtim ose ta revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht (Republika, 2019, p. 14). ( Neni 54 )

#### **Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues**

Gjkata mund të shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri ose përmbushja e kushteve të shqiptuara nga gjykata arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues. Kur shqipton dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, gjykata e urdhëron personin e dënuar që të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues. Gjkata, po ashtu mund të shqiptojë një apo më shumë nga kushtet e parapara. Kohëzgjatja e një kushti të shqiptuar nuk mund të jetë më pak se gjashtë (6) muaj e as më shumë se tre (3) vjet. Me rastin e zgjedhjes midis detyrimeve, gjykata në veçanti merr parasysh moshën e personit të dënuar; gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore; mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën; motivet për kryerjen e veprës penale; sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale; sjelljen e tij të kaluar; rrethanat e tij personale dhe ato në lidhje me familjen; dhe rrethanat tjera që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit dhe kohëzgjatjes së mbikëqyrjes. Nëse personi i dënuar nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbush detyrimin e paraparë siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes në

kuadër të kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht. (Republika, 2019, pp. 14-15) (Neni 55 )

### **Llojet e detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht**

Dënimi me kusht mund të përfshijë edhe urdhrin për të përmbushur një apo më shumë nga detyrimet e mëposhtme:

- 1) mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor;
- 2) nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;
- 3) vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre;
- 4) aftësimi profesional në një profesion të caktuar;
- 5) kryerja e aktiviteteve punuese;
- 6) shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave apo pasurisë tjetër për përmbushjen e detyrimeve familjare;
- 7) mos ndërrimi i vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues;
- 8) heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës;
- 9) heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokaleve të caktuara;
- 10) heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar;
- 11) heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve;
- 12) të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;
- 13) të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;
- 14) të mos posedojë apo përdor kompjuterin ose të mos qaset në internet siç kërkohet nga gjykata ose

15) të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata. (Republika, 2019, p. 15) ( Neni 56 )

#### *Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme*


Gjykata mund t'ia shqiptojë personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në dymijepesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar. Nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë pa pagesë, punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej tridhjetë (30) deri në dyqind e dyzet (240) orë pune.

Puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga gjykata, e cila nuk e tejkalon një (1) vit. Nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata, po ashtu, e urdhëron personin e dënuar të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues ose mund të urdhëroj kryerjen e një apo më shumë prej detyrimeve. Kohëzgjatja e detyrimit nuk duhet të jetë më e shkurtë se gjashtë (6) muaj ose më e gjatë se sa tri (3) vjet. Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, ose e kryen pjesërisht gjykata mund ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin. Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një (1) ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer. (Republika, 2019, p. 16) ( Neni 57 )

#### *Gjysmëliria*

Kur shqipton dënimin me burgim deri në një (1) vit, gjykata mund të urdhërojë ekzekutimin e dënitimit në gjysmëliri për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë esenciale familjare apo nevojën për trajtim mjekësor ose rehabilitues. Gjatë vuajtjes së dënitimit në gjysmëliri, personi i dënuar detyrohet të kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata. Kur personi i dënuar nuk i përmbush detyrimet, gjykata e revokon urdhrin për ekzekutimin e

dënimit në gjysmëliri dhe urdhëron mbajtjen e dënimit të mbetur në burg. Kur gjykata urdhëron ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri, ajo po ashtu mund të shqiptojë një apo më shumë nga kushtet e përcaktuara me nenet paragrafin 3. të nenit 48 ose nenin 56 të këtij Kodi. (Republika, 2019, p. 16) ( Neni 58 )



Statistika 1: (Kosovës, 2019)

### *Vërejtja gjyqësore*

Qëllimi i vërejtjes gjyqësore është që t'i jepet kryesit qortimi kur, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit. (Republika, 2019, p. 26) ( Neni 81 )

Me vërejtje gjyqësore kryesit i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një (1) vit ose dënimi me gjobë, në rastet kur veprat e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë veprat penale veçanërisht të lehta. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet edhe për vepra penale të caktuara për të cilat është paraparë dënimi deri në tri (3) vjet, sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Gjkata mund të shqiptojë vërejtjen e gjykatës për më shumë se një vepër penale të kryer në bashkim, nëse



për çdonjërin nga këto vepra ekzistojnë kushtet. Me rastin e vendosjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, gjykata veçanërisht merr parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, sjelljen e kryesit në të kaluarën, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale dhe pjesëmarrjen vullnetare të kryesit në programin e trajtimit. (Republika, 2019, p. 26) ( Neni 82 )

## 2.4 Masat e trajtimit të detyrueshëm

Masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat mund ti shqiptohen kryesit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo është i varur nga droga ose alkooli janë:

- 1) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
- 2) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe
- 3) trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli.

Sanksioni penal, mund t'i shqiptohet edhe kryesit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, nëse ekzistojnë shkaqe për shqiptimin e sanksionit të tillë. (Republika, 2019, p. 27) ( Neni 84 )

### *Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor*

Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor kryesit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:

- 1) kryesi ka kryer vepër penale për të cilën atij ose asaj mund ti shqiptohet dënimi me një (1) ose më shumë vite burgim;
- 2) ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë vepër tjetër penale;

- 3) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale;
- 4) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur rrezikun serioz.

Gjykata do ta pushojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik pasi të ketë vërtetuar se ka pushuar nevoja për trajtim në institucionin e kujdesit shëndetësor. Kryesit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore dhe i cili është dënuar me burgim, koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor do t'i llogaritet në kohën e dënimit të shqiptuar për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Nëse koha e mbajtur në ndalim për trajtim të detyrueshëm psikiatrik është më e shkurtër se dënimi me burgim, gjykata mund të urdhërojë që kryesi të dërgohet në burgim për të mbajtur pjesën e mbetur të dënimit ose gjykata mund të urdhërojë lirimin me kusht. Me rastin e vendosjes për lirimin me kusht, gjykata veçanërisht do të merr parasysh suksesin e trajtimit të detyrueshëm të kryesit, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucionin shëndetësor dhe kohëzgjatjen e dënimit që nuk është mbajtur. (Republika, 2019, pp. 27-28) ( Neni 85 )

#### *Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri*

Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri kryesit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:

- 1) ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë veprë penale;
- 2) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penal; dhe
- 3) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz.

Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri mund t'i shqiptohen kryesit ndaj të cilit është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, kur gjykata vërteton se ndalimi në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk është

më i nevojshëm dhe se masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri mjafton. Gjykata mund t’i shqiptojë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri kryesit me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore dhe i cili është në liri me kusht. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet nëse i është shqiptuar kryesit me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore.

Gjykata mund të shqiptojë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor: kur kryesi nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri; kur kryesi braktis trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri; ose kur përkundër trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, ka rrezik serioz se kryesi prapë do të kryejë veprë penale. (Republika, 2019, p. 28) ( Neni 86 )

#### *Trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm i personave të varur nga droga ose*

##### *alkooli*

Gjykata mund t’i urdhërojë masën e trajtimit me rehabilitim të detyrueshëm në institucionin e kujdesit shëndetësor kryesit i cili ka kryer veprën penale nën ndikimin e drogës apo alkoolit, nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- 1) gjykata ka shqiptuar dënim, vërejtje gjyqësore ose kryesin e ka liruar nga dënimi; dhe
- 2) gjykata konstaton se faktori kryesor që e ka motivuar kryerjen e veprës penale ishte varësia e kryesit nga alkooli apo droga dhe nëse ka gjasa për mjekimin e tij të suksesshëm.

Nëse shqiptohet masa, krahas dënimit me gjobë, vërejtjes gjyqësore apo lirimit nga dënimi, gjykata mund të vendosë, me pëlqimin e të dënuarit, që masa e tillë të ekzekutohet në liri. Nëse kryesi pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet trajtimit në liri ose arbitrarisht e braktis trajtimin, gjykata mund të urdhërojë që trajtimi të ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor. Nëse masa është shqiptuar krahas dënimit me gjobë, vërejtjes gjyqësore apo lirimit nga dënimi, trajtimi nuk mund të zgjasë më tepër se dy (2) vjet. Nëse masa është shqiptuar krahas dënimit me burgim, ajo mund të zgjasë derisa të kryhet dënimi. Koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor do të llogaritet në dënimin e shqiptuar. Gjykata duhet të

shqyrtojë ekzekutimin e kësaj mase çdo dy (2) muaj për të vendosur nëse është e nevojshme të vazhdohet masa. (Republika, 2019, p. 29) ( Neni 87 )

## Kapitulli i katërt

### 1. Ngjashmëritë dhe dallimet

Sanksionet penale në të dy vendet janë të definuar njëjtë dhe qëllimet janë të njëjta. Nga autorët e të dy vendeve thuhet se sanksionet penale janë masa që i shqiptohen kryerësit të veprave penale e që konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave. Janë masa të reagimit të shtetit ndaj kriminalitetit të cilat i shqipton gjykata nëpërmjet vendimit gjyqësorë. Qëllimi i sanksioneve penale nuk është vetëm arritja e drejtësisë por edhe përmirësimi apo riedukimi i kryerësit të veprave penale.

Sanksionet penale në të dy vendet ndahen në: dënime kryesore, dënime plotësuese, masa alternative dhe masa të sigurisë. Dallimi qëndron në atë se në RMV në kuadër të dënimeve hyjnë si dënimet kryesore ashtu edhe ata plotësuese, ndërsa në RK ata përmenden veç e veç. Vërejtja gjyqësore që në RK parashihet si dënim i veçantë në RMV ky lloj dënimi bën pjesë te masat alternative. “Masat e sigurisë” në RK i gjejmë me emërtimin “Masat e trajtimit të detyrueshëm”

#### 1.1 Ngjashmëritë dhe dallimet e Dënimeve kryesore

Dënimi me heqje të lirisë është i pranishëm pothuajse në të gjitha vendet dhe përveç tij edhe dënimi kapital nuk është hequr në të gjitha vendet. Më pak ideologjik dhe më shumë teknik është kategorizimi ose ndarja në dënime kryesore (kur çmohet se mjaftojnë vetëm ato për të


realizuar qëllimin) dhe dënime plotësuese (të cilat mund të shoqërojnë një dënim kryesor). (Shegani, 2002, p. 131)

Si dënime kryesore në të dy vendet mund të shqiptohet dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë.

Në RK si dënim kryesor mund të shqiptohet edhe dënimi me burgim të përjetshëm i cili në RMV nuk parashihet në kuadër të dënimeve kryesore, por mund të shqiptohet për disa vepra penale më të rënda siç janë: gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e agresionit, krimet ushtarake kundër popullatës civile, terrorizmi ndërkombëtarë, vrasja dhe plagosja e paligjshme e armikut etj. Ismail Zejneli për veprën penale gjenocidi thotë se “Për këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej së paku 10 vitesh apo dënimi me burgim të përjetshëm” (Zejneli I. , E drejta penale- pjesa e posaçme, 2007 , p. 172). Po ashtu në nenin 405 të KP të RMV thuhet se “Ai i cili gjatë kohës së luftës ose konfliktit të armatosur duke i shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare do të urdhëroj që të plagosurit, sëmurit ose personel sanitar të vriten, mundohen, të veprohet jo njerëzisht me ta, të kryhen eksperimente biologjike, mjekësore ose eksperimente tjera shkencore, [...] ose ai i cili do ta kryejë ndonjë nga veprat e përmendura, do të dënohet me së paku dhjet vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. (Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral, 2015, p. 339). Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t’u shqiptohet personave që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i kanë mbushur 21 vjet as në RK e as në RMV.


Në RK si qëllime të dënimit përpos që ta parandalojë kryerësin që të kryejë vepra penale dhe riedukimin e tij dhe që të ndikojë që të tjerët të mos kryejnë vepra penale, me ndryshimet e bëra në vitin 2013, parashihen edhe kompensimi i viktimave ose komunitetit për dëmin e shkaktuar dhe ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit.

*Dënimi me burgim-* Në të dy vendet burgimi nuk mund të shqiptohet në më pak se 30 ditë, ndërsa maksimumi ndryshon. Në RK është 25 vjet, në RMV 20 vjet. Për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me burgim të përjetshëm në RMV mund të shqiptohet dënim afatgjatë prej 40 vjet, ndërsa në RK 35 vjet.



Statistika 2: (Krsteva & Krstev, 2019) (Kosovës, 2019)

*Dënimi me gjobë*- Minimumi dhe maksimumi i dënimit me gjobë është i ndryshëm në të dyja vendet e kjo kuptohet nga vet valutat që i shfrytëzojnë këto të dy vende. Në RMV dënimi me gjobë shqiptohet në gjoba ditore. Afatet për pagesën e dënimit me gjobë janë të njëjta minimumi 15 dit, maksimumi 3 muaj. Në të dy vendet lejohet që dënimi me gjobë të paguhet edhe në këste e që periodha e pagesës me këste nuk mund ti kalojë dy vjet. Dënimi me gjobë mund të zëvendësohet si me dënim me burgim ashtu edhe me masën e punës në dobi të përgjithshme. Kur bëhet zëvendësimi i dënimit me gjobë me dënim me burg, burgu në RMV nuk mund të jete më i gjatë se gjashtë muaj, për dallim nga RK që lejohet të jetë deri në tre vjet, kjo e kuptueshme edhe nga vet minimumi dhe maksimumi i dënimit me gjobë. Nëse një pjesë e dënimit me gjobë paguhet e një pjesë jo, pjesa e mbetur mund të zëvendësohet me dënim me burg, e nëse edhe pjesa e mbetur paguhet nga i dënuari në të dyja vendet dënimi me burg ndërpritet. Dënimi me gjobë kur zëvendësohet me masën e punës në dobi të përgjithshme nuk mund ti tejkalojë 240 orë pune. Dënimi me gjobë nuk ekzekutohet pas vdekjes së personit.



Statistika 3: (Krsteva & Krstev, 2019) (Kosovës, 2019)

## 1.2 Ngjashmëritë dhe dallimet e Dënimeve plotësuese

Te dënimet plotësuese RMV si dhe RK kanë mjaft ndryshime. Ka dënime të cilat nuk i parasheh RMV si dhe dënime të cilat i parasheh RMV por jo edhe RK. Dënimet plotësuese të cilat i parasheh Kodi penal i RK e jo Kodi penal i RMV janë: heqja e të drejtës për t'u zgjedhur, urdhëri për kompensimin e humbjes apo dëmit, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, marrja e lejes së vozitjes ( edhe pse parashihet që mund të merret leja e vozitjes në nenin 38c paragrafi 2 ) dhe urdhëri për publikimin e aktgjykimit. Ndërsa dënimi plotësues që mund të shqiptohet në RMV e jo edhe në RK është ndalesa për vizitimin e ndeshjeve sportive ( edhe pse në Rregulloren e garave finale 2019-2020 parashihen disa masa për personat fizik ku thuhet se: Në lidhje me personat privat (individë): a) Vërejtje; b) gjobë; c) largim; d) suspendim për një numër të caktuar ndeshjesh ose periudhë të caktuar; e) ndalim prezence në zhveshtore apo bankën e "rezervistëve"; f) ndalesa e marrjes pjesë në çdo aktivitet të lidhur me futbollin (FFK-se, 2019, p. 33) ( Neni 76 pika 2 )

*Ndalesa për të ushtruar profesion veprimtari apo detyrë-* Ndalesa u shqiptohet të gjithë atyre të cilët e kanë keqpërdorur ose mund ta keqpërdorin profesionin e tyre për të kryer vepër penale. Kjo ndalesë shqiptohet prej minimum 1 viti e maksimumi në RMV deri në 10 vjet, ndërsa në RK deri në 5 vjet ( përjashtimisht për disa vepra penale edhe deri në 10 vjet ). Koha e mbajtur në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit. Lirimi me kusht revokohet nëse kryerësi e shkel ndalesën.

Sipas statistikave të vitit 2018 kjo ndalesë është shqiptuar në RMV 4 herë, ndërsa në RK vetëm dy herë. (Krsteva & Krstev, 2019) (Kosovës, 2019)

*Ndalesa për të drejtuar automjetin-* Ajo që është e njëjtë për të dy vendet në këtë ndalesë është kohëzgjatja e kësaj ndalesë e cila nuk mund të jetë më pak se 1 vit e as me shumë se 5 vjet. Koha e kaluar në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit. Dënimi me kusht mund të revokohet nëse kryerësi e shkel ndalesën. Për personat të cilët kanë leje të huaj të vozitjes ndalesa vlen vetëm për përdorimin e lejes në territorin e shtetit. Dallimi qëndron në atë se në RMV kur kryerësi me profesion është shofer i automjetit ndalesa mund të zgjat edhe deri në 10 vjet. Ndërsa në RK dënimi me kusht nuk mund të revokohet nëse paraqiten rrethana të jashtëzakonshme që kërkojnë që kryerësi ta drejtojë automjetin.

Ndalesa për të drejtuar automjetin, sipas statistikave të enteve shtetërore të vitit 2018 është shqiptuar më shumë në RMV me gjithësej 41 ndalesa, ndërsa në RK janë shqiptuar vetëm 5 ndalesa të tilla. (Krsteva & Krstev, 2019) (Kosovës, 2019)

*Dëbimi i të huajit nga vendi-* Ky lloj i dënimit është i njëjtë në të gjitha aspektet të të dy vendet si për nga kohëzgjatja që nuk mund të jetë më pak se 1 vit e as me shumë se 10 vjet, po ashtu edhe se nuk mund tu shqiptohet personave të cilët gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare. Me vetëm një ndryshim në kohëzgjatjen e dënimit i cili në RMV mund të jetë edhe i përhershëm.



### 1.3 Ngjashmëritë dhe dallimet e Masave alternative

Me anë të dënimeve alternative në masë shumë më të vogël se me burgim, kryerësit privohen nga liritë dhe të drejtat e tyre. Gjithashtu, është konstatuar se ndaj një numri të konsiderueshëm të kryerësve të veprave të lehta penale, nuk është e domosdoshme të shqiptohen dënime me burgim, ngase efekti i risocializimit dhe i preventivës mund të arrihet edhe me dënime joizoluese, pra jo me burgim. (Salihu, 2011, p. 78)

Si dënime alternative në të dy vendet mund të shqiptohet: dënimi me kusht, dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse ose në RK e cekur si urdhëri për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues dhe puna në dobi të përgjithshme, si dhe vërejtja gjyqësore edhe pse në RK ky dënim nuk bënë pjesë të dënimeve alternative. Dënimet alternative që i përmban Kodi penal i RK ndërsa nuk i ka Kodi penal i RMV janë: gjysmëliria dhe urdhëri për trajtim të detyrueshëm rehabilitues. Dënimet alternative që i përmban Kodi penal i RMV dhe jo edhe ai i RK janë: ndërprerja me kusht e procedurës penale dhe burgu shtëpiak.


*Dënimi me kusht*- Koha e kontrollit e dënimit me kusht nuk mund të jetë më e shkurt se 1 vit e as më e gjatë se 5 vite të të dy vendet. Dënimi me kusht mund të ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me vepër penale ose nuk e kompenson dëmin e shkaktuar ose nuk i përmbush detyrimet tjera. Dënimi me kusht në RMV mund të shqiptohet kryerësit të cilit i është caktuar dënim me burg deri në dy vjet ose dënim me gjobë, ndërsa në RK ky lloj dënimi i shqiptohet kryerësit të cilit i është caktuar dënim me burg deri në 5 vjet në disa raste edhe deri në 10 vjet. Kur gjykata ka shqiptuar dënim me burg si dhe dënim me gjobë, dënimi me kusht mund të shqiptohet për të dy dënimet ose vetëm për dënimin me burg. Revokimi i dënimit me kusht në të dy vendet bëhet në kushte, për arsye dhe afate të njëjta.

*Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse- në RK Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovuës-* Ky lloj i dënimit shqiptohet në rastet kur mendohet se dënimi me kusht do të duhet të mbikëqyret nga ndonjë organ që të përmbushet më mirë qëllimi për të cilin është shqiptuar. Kohëzgjatja e tij dallon, në RMV mund të zgjas nga 1 deri në 5 vjet, ndërsa në RK nga 6 muaj deri në 3 vjet. Gjatë kësaj periudhe gjykata mund që të dënuarit ti caktojë disa detyrime që janë përafërsisht të njëjta në të dy vendet si p.sh.: aftësim profesional, nënshtrim në programe të rehabilitimit ose mjekimit, heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës, mos vizitimi i disa lokaleve të caktuara, mos kontakti me disa persona të caktuar, përmbushja e detyrimeve familjare etj. Nëse detyrimet nuk përmbushen gjykata mund që ta zgjas afatin e përmbushjes së detyrimeve, ta zëvendësoj obligimin e caktuar me një obligim tjetër ose ta revokojë dënimin.

*Puna në dobi të përgjithshme-* Kjo masë mund të shqiptohet për veprat për të cilat është paraparë dënim me burg apo dënim me gjobë. Në RMV kjo masë mund të shqiptohet nëse për veprën e tillë është paraparë dënim me burgim deri në 3 vjet, ndërsa në RK deri në 1 vit. Kjo masë mund të shqiptohet vetëm me pëlqimin e të dënuarit e cila nuk mund të jetë me e shkurtër se 40 orë e as më e gjat se 240 orë në vit në RMV, më e shkurtër se 30 orë e as më e gjat se 240 orë në vit në RK. Nëse puna në dobi të përgjithshme nuk është kryer atëherë gjykata mund ta zgjasë afatin për përmbushjen e orëve të punës ose mund të urdhërojë dënimin me burg i cili në RMV 1 dit burg për çdo tre orë punë, në RK 1 dit burg për çdo 8 orë punë.

Puna në dobi të përgjithshme në RMV që nga viti 2009 e deri në vitin 2018 është shqiptuar vetëm dy herë në vitin 2012, për dallim nga RK ku është shqiptuar më shumë edhe atë: në vitin 2014 – 128 herë, në vitin 2016 – 71 herë, në vitin 2017 – 89 herë dhe në vitin 2018 – 37 herë. (Krsteva & Krstev, 2019) (Kosovës, 2019)

*Vërejtja gjyqësore-* Shqiptohet për veprat penale që janë kryer në rrethana veçanërisht lehtësuese dhe për të cilat është paraparë dënim me burg deri në një vit, e në disa raste edhe deri në 3 vite. Mund të shqiptohet edhe për më shumë vepra penale të kryera në bashkim nëse për secilën prej tyre ekzistojnë kushte. Kjo masë nuk ka asnjë ndryshim në asnjërin prej vendeve.



Statistika 4: (Krsteva & Krstev, 2019) (Kosovës, 2019)

#### 1.4 Ngjashmëritë dhe dallimet e Masave të trajtimit të detyrueshëm

Pjesa me më shumë ngjashmëri në të dy vendet është pjesa e masave të trajtimit të detyrueshëm e që në RMV këto masa njihen me emërtimin masa të sigurisë. Ka tre lloje të masave të trajtimit të detyrueshëm që i shqipton gjykata për kryerësit e papërgjegjshëm ose për kryerësit me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar e ato janë: mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në institucionin shëndetësorë, mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve. Të gjitha këto lloje të masave shqiptohen në kushte të njëjta, për arsye të njëjta dhe më kohëzgjatje të njëjtë, përveç mjekimit të detyrueshëm në liri i cili në RMV nuk mund të zgjas më shumë se dy vjet, ndërsa në RK më shumë se tre vjet. Ajo që i dallon këto masa është masa e mjekimit medicinalo-farmakologjik e cila parashihet si masë e sigurisë në Kodin penal të RMV mirëpo jo edhe në atë të RK.

## 2. Konkluzione dhe rekomandime

Organet shtetërore, para së gjithash, ato kompetenca e të cilëve është zbulimi, ndjekja, gjykimi dhe përmbartimi i sanksioneve për vepra penale (policia, prokuroria publike, gjykata, institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penalo-juridike), janë të obliguar ta zbatojnë ligjin penal pa asnjë përjashtim. Lufta kundër kriminalitetit është detyrë parësore e organeve shtetërore. Politizmi i funksioneve të larta publike, shtrirja e klientelizmit, shtimi i korrupsionit të butë e tjetërsojnë thelbin e shtetit. (Zejneli J. , 2013, pp. 193-194)

Për t’u mbrojtur sovraniteti i shtetit, liritë dhe të drejtat e qytetarëve, për t’u dënuar personat e fajshëm, për t’u riedukuar personat kryerës të veprave penale, për të gjetur zgjidhje dhe për t’i shëruar personat që kryejnë vepra penale nga papërgjegjësia e tyre ose si ndikim nga ndonjë sëmundje patologjike, si në RMV po ashtu edhe në RK pamë se sistemi i sanksioneve penale përmban llojllojshmëri të dënimeve dhe masave që mund tu shqiptohen kryerësve të veprave penale.

Kushtet, rrethanat, afatet dhe kohëzgjatja e sanksioneve penale që janë të njëjta për të dyja vendet, ndryshojnë mjaft pak ose edhe aspak nga njëri – tjetri. Megjithatë, ata nuk janë shqiptuar njëjtë sa në vendin tonë edhe në vendin fqinjë.

Masat të cilat i posedon Kodi Penal i RMV-së e nuk i posedon ai i RK-së dhe anasjelltas nuk janë shqiptuar pothuajse asnjëherë ose janë shqiptuar në masë shumë të vogël. Edhe pse nuk janë shqiptuar pothuajse asnjëherë përsëri si masa që vendi ynë duhet t’i implementojë në Kodin Penal janë: ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik dhe gjysmëliria. Ndërsa dënimet apo masat të cilat duhet t’i implementojë RK janë: ndalesa për vizitimin e ndeshjeve sportive, burgimi shtëpiak dhe mjekimi medicinalo-farmakologjik.

Në bazë të statistikave të dy vendeve del se në vendin tonë më shumë shqiptohen dënimet se sa masat tjera alternative, përkundër Kosovës ku shqiptimi i masave alternative është në numër shumë më të madh se sa shqiptimi i dënimeve.

Me sa duket e rëndësishme për gjyqësinë e vendit tonë është që kryerësi të dënohet, e më pak i kushtohet kujdes procesit të risocializimit dhe shërimit të kryerësve të papërgjegjshëm apo me përgjegjësi të zvogëluar. Kjo mund të jetë kështu edhe nga mos pasja e kushteve për ekzekutimin e masave të tilla apo edhe nga mosndërmarrja e asnjë hapi drejt asaj që të plotësohen këto kushte për shqiptimin dhe ekzekutimin e masave alternative.

Dënimet dhe masat të cilat i posedojnë këto dy vende nuk duhet të hiqen edhe pse nuk shqiptohen, por duhet shqiptuar më shumë dhe duhet krijuar kushte për ekzekutimin e tyre në mënyrë sa më të mirë të mundshme që të arrihet qëllimi i secilës prej tyre.

Duke u bazuar në shumëllojshmërinë e veprave penale dhe në atë se asnjë vepër penale nuk është e njëjtë me një vepër tjetër penale, e që ndryshojnë nga njëra – tjetra në mos nga mënyra e kryerjes së tyre nga motivet ose anasjelltas, ose edhe nga kushtet dhe rrethanat që shpiejnë deri në kryerjen e veprës penale, shumëllojshmëria e sanksioneve penale do të mundësonte që ndaj secilit kryerës të shqiptohet dënimi apo masa e duhur dhe më e përshtatur për çdo rast konkret. Ndaj edhe nuk duhet të hiqen dënimet dhe masat, por duhet të shtohen dhe të krijohen kushte për zbatimin e secilës prej tyre.

Duhet pasur parasysh faktin se me shqiptimin e sanksionit penal ndaj kryerësit përgjegjës të veprës penale ende nuk është arritur qëllimi përfundimtar i të Drejtës penale në kuptimin e gjerë-qëllimi që ndaj kryerësit përgjegjës të veprës penale të zbatohet sanksioni i shqiptuar. Edhe vet personi ndaj të cilit është shqiptuar sanksioni shpeshherë duhet që në mënyrë përkatëse të marrë pjesë në zbatimin e sanksionit. (Sahiti & Zejneli, 2017, p. 5) Po ashtu i një rëndësie teje të madhe është edhe bashkëpunimi i organeve të cilët sjellin aktgjykime dhe atyre që duhet t’i ekzekutojnë sanksionet, organeve shtetërore dhe organizatave joqeveritare, madje edhe i të gjithë këtyre me qytetarët. As shteti nuk do të ekzistonte pa qytetarë e as qytetarët nuk do të kishin një jetë të qëndrueshme dhe të rehatshme pa organet shtetërore të cilët i mbrojnë të drejtat e qytetarëve, ndaj edhe bashkëpunimi mes tyre duhet të mos mungojë asnjëherë.

## Përfundimi

Qëllimi i secilit hulumtues është që me hulumtimin e tij ti japë shkencës ide dhe mendime të reja për çështjen të cilën e hulumton. Të arrijë në përfundime të reja pikërisht me mundin dhe vetiniciativën dhe të mund të japë kontributin e tij për zhvillimin e shkencës dhe për ta bërë atë të ecë përpara.

Se si do të përfundojë punimi varet plotësisht nga ajo se si ai punim është punuar, sa i është kushtuar atij rëndësia të cilin e ka, sa vëmendje ka pasur studiuesi gjatë hulumtimit e shumë faktorë të tjerë. Megjithatë që një punim të jetë shkencorë dhe aq më tepër praktik ai duhet të punohet më një përkushtim të madh dhe me një dëshirë të madhe.

Është po ashtu më rëndësi që tema e hulumtimit ti përshtatet dëshirës se hulumtuesit dhe kureshtjes së tij.

Duke qenë se secili shtet ka detyrë që të parandalojë dhe pengojë kriminalitetin e kjo nuk bëhet veçse me masat të cilat i ndërrmer shteti me monopolin e ushtrimit të dhunës që ai e gëzon, kjo nënkupton se shteti duhet të jetë përherë aktiv dhe i gatshëm për ndryshime. Duhet që përherë të jetë në gjendje dhe në gaditshmëri që sa herë që të paraqitet nevoja të bëhen ndryshime në legjislacion dhe implikim i masave të cilat janë më se të nevojshme për kryerjen e detyrës së shtetit në mënyrën më të mirë të mundshme. Çdoherë duhet të bëhen përshtatje të masave të dhunës me të keqen që kanoset. Në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që masat të cilat nuk kanë efekt për ndalimin dhe pengimin e kriminalitetit të lihen të qëndrojnë ashtu siç janë vetëm sa për ta “përbushur numrin” e sanksioneve penale. Shteti dhe edhe ne si qytetarë duhet që të jemi për herë syhapur dhe të zhvillojmë hulumtime sa herë që të jetë nevoja që të bëhen

ndryshime. Duhet tu jepet një rëndësi e madhe të gjitha ndryshimeve që do të bëhen në mënyrë që ata të kenë efekt dhe të tregojnë rezultate pozitive.

Çdo ndryshim i bërë përmban në vete një rrezik lidhur me atë se sa ai do të tregojë efektin e vet, sa do të përshtatet me rrethin shoqërorë, dhe sa do të ketë kushte për realizimin e tij të drejtë dhe të plotë. Por prap se prap rreziku duhet të ndërmerret sepse pa mos rrezikuar nuk mund ti dimë përfundimet. Mirëpo edhe pse ekziston rreziku ai do të jetë shumë më i vogël në rast se ndryshimet do të bëhen duke u bazuar në idetë dhe mendimet e personave të cilët janë specialist në fushat e tyre, si dhe duke u bazuar në sa më tepër hulumtime të reja dhe të punuara në mënyrë të mirëfillt shkencore.

Përparimi i shtetit nënkupton përparimin e shoqërisë e nuk ka se si kjo të ndodhë pa bashkëpunimin e shtetit me shkencëtarët e së ardhmes.

## Bibliografia

- Alsat-m. (2016, Nentor 8). *Alsat M*. Gjetur në <https://alsat-m.tv/290428/>
- Boletini, E. (2019, Korrik 20). *Telegrafi.com*. Gjetur në <https://telegrafi.com/keto-jane-tri-rastet-kur-eshte-shqiptuar-denimi-burgim-te-perjetshem-ne-kosove-qe-nga-viti-2013/>
- FFK-se, K. e. (2019, Korrik 30). *ffk-Kosova*. Gjetur në <http://ffk-kosova.com/wp-content/uploads/2019/08/Rregullorja-e-Garave-Finale-2019-2020.pdf>
- Halili, R. (2014). *Penologjia-E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale*. Prishtinë.
- Hoxha, R. (a.d.). *Avokatura*. Gjetur në Shërbime juridike:  
<http://www.avokatura.com/sq/Blog/Kuptimi-dhe-p%C3%ABrkufizimi-i-Sanksionit-penal>
- Klimovski, S., Mitkov, V., Treneska, R., & Karakamisheva, T. (2004). *Rregullimi kushtetues i Republikës së Maqedonisë*. Shkup: Prosvetno dello SHA.
- Kosovës, A. e. (2019, Shtator). *Agjencia e Statistikave të Kosovës*. Gjetur në <http://ask.rks-gov.net/>
- Krsteva, S., & Krstev, T. (2019, May 30). *Enti Shtetërorë i Statistikës*. Gjetur në <http://www.stat.gov.mk>
- Osmani, A. (2015). *Kodi penal i Republikës së Maqedonisë-Teksti integral*. Shkup.
- Osmani, A. (2017). *Penologjia*. Shkup.
- Republika, E. K. (2019, Janar 14). *Kodi Penal*. Gjetur në <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>



- RMV, Q. e. (2013, Nentor 13). *Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut*. Gjetur në <https://vlada.mk/node/7683?ln=sq>
- Sahiti, E., & Zejneli, I. (2017). *E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë*. Shkup.
- Salihu, I. (2011). *E Drejta Penale Ndërkombëtare*. Prishtinë: Shtypshkronja KGT.
- Shegani, A. (2002). *E Drejtë Penale e Krahasuar*. Tiranë.
- Zejneli, I. (2007 ). *E drejta penale- pjesa e posaçme*. Tetovë.
- Zejneli, I., & Kambovski, V. (2018). *E drejta penale-pjesa e përgjithshme*. Tetovë.
- Zejneli, J. (2013). *Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë*. Tetovë: Arbëria Design.
- Правдико. (2014, Април 24). *Затворски казни за дивеење на спортски натпревари*. Gjetur në Правдико-имаш право да знаеш: <https://www.pravdiko.mk/zatvorski-kazni-za-diveene-na-sportski-natprevari/#more-8276>
- СЕВЕРНА, С. Н. (2019, Јуни 17). *Закон за извршување на санкциите*. Gjetur në Министерство за правда: <https://www.pravda.gov.mk/uis-novostd/2982#>

